USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS
DHE SABOTIMI I ADEM JASHARIT

(Bashkëbisedim me Idriz Mehmetin)

~~~~~~

- Kush është Idriz Mehmeti -

Idriz Mehmeti ka lindur me 26.06.1956 në fshatin Krasmirofc të Skënderajt. Shtatë klasët e shkollën fillore i kreu në fshatin Gradicë të Drenasit (ish Gllogovc), ndërsa klasën e tetë në fshatin Qirez të Skënderajt. Edhe shkollën e mesme teknike e kreu në dy shkolla: në Prishtinë dhe në Drenas. Ka studiuar në fakultetin Teknologjik në Mitrovicë, por, për shkak të pengesave, nuk arriti t'i përfundonte studimet. Me mbështetjen e Shoqatës së ish të Burgosurve Politikë të Kosovës, i ka botuar tri libra: "Rrëfimet në vetën e parë", "Si e njoha
~~~~~~

Adem Jasharin!" dhe "Ata ishin një (Fehmi e Xhevë Lladrovci)". Librin e katërt e ka në përfundim.

Ka qenë i burgosur politik qysh në vitin1 975, bashkë me shumë atdhetarë tjerë me në krye Adem Demaçin, simbolin e qëndresës kombëtare. U dënua me grupin e Adem Rukiqit, më 28 shkurt 1976. Edhe pas daljes nga burgu ka vazhduar aktivitetin politik në rrethana ilegale, deri në fillim të viteve 90'të. E ka njohur Adem Jasharin dhe ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me familjen Jashari në Prekaz.

Në fillim të nëntorit 1993, Idrizi i ka shpëtuar arrestimit nga forcat policore serbe, të cilat më pas i bastisën shtëpinë.

Në fund të janarit 1994 detyrohet të largohet nga Kosova dhe emigron në Zvicër, ku jeton edhe sot me familjen e tij: me bashkëshorten Florijen, dy djemtë (Albanin e Dardanin), dy gocat (Valbonën e Jehonën), dy mbesat (Adean dhe Doan) dhe me nipat Dion e Detjon.

Nga vjeshta e vitit 1994 deri në fund të majit 1998 mbante pozitën e kryetarit të shoqatës "Drenica" në Zvicër. Gjatë periudhës 1985-86 ishte kryetar i Klubit "Hasan Prishtina" në Bern. Nga vjeshta e vitit 1995 e deri më 5 Mars 1998 ishte edhe anëtar i LDK-së, dega në Zvicër. Me 5 mars 1998, (atë ditë kur nisi lufta në Prekaz), Idrizi jep dorëheqje me shkrim nga LDK-ja. I shkruan letër edhe Kryeministrit në ekzil, Bujar Bukoshit. Në qershor 1998 Idrizi kthehet në Kosovë dhe i bashkohet radhëve të UÇK-së. Gjatë ofensivës së verës 1998 merr pjesë në luftime të zhvilluar në zonën e Drenicës. Në nëntor 1998 kthehet në Zvicër dhe vazhdon aktivitetet në ndihmë të UÇK-së. Me shpalljen e Mobilizimit të Përgjithshëm nga SHP i UÇK-së (më 31 mars 1999), Idriz Mehmeti në fillim të prillit (1999) sërish i bashkohet radhëve të UÇK-së, në zonën e veriut në Shqipëri, ku komandant i kësaj zone kufitare ishte Xheladin Gashi-Plaku. Baci Idriz, u emrua zv.komandant për tri qendra stërvitore në Vlahnë, Cahan dhe Helshan dhe këtë detyrë e kreu deri në mesin e muajit maj 1999…

- Idriz Mehmeti -

Duke pasur parasysh këtë aktivitet, me veprimtarin Idriz Mehmeti zhvillova këtë bashkëbisedim.

Sheradin Berisha: *Baci Idriz, fillimisht ju shpreh mirënjohje që pranuat të bashkëbisedojmë për aktivitetin tuaj shumëvjeçar. Kam mendimin ta nisim me prostetat e fundviteve 80-të! Siç dihet intensifikimi për "Serbinë unike" përmes ndryshimeve kushtetuese, nisi në maj të vitit 1986 me ardhjen e Sllobodan Millosheviçit nga kryetar i Komitetit të LK'së për Beogradin, në kryetar i KQ të LK të Serbisë. Platforma ideologjike e Millosheviçit bazohej në Memorandumin e Akademisë së Shkencave të Serbisë, i hartuar në shtator të vitit 1986. Ky memorandum u shndërrua edhe në një armë të fortë për Millosheviçin, për të mobilizuar popullin serb në realizimin e synimeve hegjemoniste serbe në Kosovë. Dhe ky rrugëtim hegjemonist nisi më 24 prill 1987, me legjitimimin e lëvizjes nacional-shoviniste serbe, me seli në Fushë Kosovë, me atë protestën e famshme të serbëve, ku Millosheviçi deklaroi: "nuk guxon t'ju prek askush me gishtë!" Më 21 janar 1987 Kryesia Federale kishte propozuar fillimin e ndryshimeve në Kushtetutën Federale, duke përfshirë 29 amandamente (nga 9 - 37). Në*

këtë kuadër, më 28 korrik 1987 edhe Kuvendi i Serbisë vendosi të bënte ndryshime në Kushtetutën e Serbisë. Më 14 shtator 1987 Kuvendi i Serbisë u dërgoi Kuvendit të Kosovës dhe atij të Vojvodinës propozimin për ndryshimet në Kushtetutën e Serbisë, "për të dhënë pëlqimin", për ato ndryshime që do t'u përkisnin çështjeve "me interes për Serbinë (unike) si tërësi".

Në mbledhjet e Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 6 nëntor 1987 dhe 2 shkurt 1988, u miratua propozimi i Kryesisë së Kosovës për të bërë ndryshimet e kërkuara në Kushtetutën e Kosovës, sipas direktivave të Serbisë. Gjatë verës së vitit 1988, (pikërisht në kohën kur Millosheviçi intensifikoi veprimet politike përmes "metingjeve antiburokratike" të organizuar nga shovinistët serbe të Kosovës, me seli në Fushë Kosovë), u bënë përgatitjet organizative - politike, për formimin e këshillave koordinues në organet e Lidhjes Socialiste, të aktivave politike etj., që do të jenë bartëse të procesit për ndryshimet substanciale në Kushtetutën e Kosovës. Kuvendi i Kosovës më 22 shtator 1988 miratoi projektin e ndryshimeve Kushtetuese në Kushtetutën e Kosovës. Ky projekt përfshinte ndryshimin e 142 dispozitave të Kushtetutës së Kosovës, në amandamentet 18 - 51. Diskutimi publik u zhvillua deri më 31 tetor 1988, në 1597 shoqata e 350 konferenca lokale dhe në 2.427 organizata themelore punuse qeverisëse. Këto zhvillime, të cilat po e shkatërronin edhe atë copë autonomie që kishte Kosova, shkaktuan një valë protestash në Kosovë. Nga 17-21 nëntor 1988 në Prishtinë e në qytete tjera të Kosovës u organizuan protesta gjithëpopullore, dhe kjo valë protestash nisi në mëngjesin e 17 nëntorit me marshimin e minatorëve të Trepçës nga miniera e Stan-Tërgut për në Prishtinë. Me minatorët u solidarizuan studentët e UP-së dhe i gjithë populli, por jo edhe strukturat politike shqiptare të këtij regjimi, të cilat këto protesta i cilësuan si armiqësore e kundërevolucionare.

Më 22 shkurt 1989 ndryshimet në kushtetutën serbe u miratuan njëzëri nga komisioni kushtetues i Serbisë. Ndërkaq, dy ditë më vonë, pasoi miratimi unanim i kushtetutës në seancën plenare të parlamentit serb, dhe për çudi delegatët e Kosovës nuk dhanë asnjë vërejtje në këtë

drejtim. Kryetari i komisionit kushtetues në parlamentin serb, Borisav Joviç, me paturpësinë më të madhe deklaroi, se "reforma kushtetuese serbe nuk e kërcënon aspak autonominë e krahinave" dhe se vetëm tani Serbia "gjendet në rrugën drejt barazisë me republikat e tjera"!

Nga 20-28 shkurti 1989 sërish ishin minatorët ata që i kundërshtuan me grevë të përgjithshme ndryshimet kushtetuese në dëmë të Kosovës, duke u ngujuar në galeritë e tyre të punës. Këtë herë artikuluan 10 kërkesa dhe njëra prej tyre ishte: "Të jepnin dorëheqje të parevokueshme: Rrahman Morina, kryetar i Kryesisë së Komitetit Krahinor të LK të Kosovës; Husamedin Azemi, kryetar i Kryesisë së Komitetit Komunal të LK të Prishtinës dhe Ali Shukria, anëtar i Komitetit Qëndror të LK të Jugosllavisë". Një ditë pas fillimit të grevës së minatorëve, (më 21 shkurt), 215 intelektualë shqiptarë i drejtuan një Apel opinionit të gjerë publik dhe strukturave pushtetore të Jugosllavisë, Serbisë dhe të Kosovës.

Më 22 shkurt, Kryesia e KQ të LKJ-së mbajti mbledhjen e jashtëzakonshme për të shqyrtuar zhvillimin e ngjarjeve më të reja në Kosovë, ndërsa një ditë më vonë, (23 shkurt), për të njejtën çështje u mblodh edhe Kryesia e Federatës Jugosllave, dhe këto organe nxorën përfundimin, se: "Ndërrimet e propozuara të Kushtetutës së Serbisë duhet të miratohen në mënyrë të pashtyshme". (!!!)

Më 24 shkurt me kërkesën ultimative të minatorëve, Stipe Shuvar, kryetar i KQ të LKJ-së, dhe Sllobodan Millosheviç vizituan Kosovën. I pari u takua me minatorët gervistë, ndërsa i dyti, i shoqëruar nga Rrahman Morina, Husamedin Azemi e të tjerë, mbajti një mbledhje me udhëheqës të Elektroekonomisë së Kosovës!

Duke qenë se minatorët nuk kishin ndërmend të dilnin nga greva, në datat 25 e 26 shkurt Millosheviçi përdori të gjitha mjetet që kishte në dispozicion, duke arritur të shpallte gjendjen e jashtëzakonshme dhe të dërgonte trupa speciale në Kosovë, me miratimin e Kryesisë së Federatës Jugosllave, në krye të së cilës ishte boshnjaku Raif Dizdareviç. Kjo ndodhi në mbledhjen e kryesisë së RSFJ-së, më 26 - 27

shkurt. Në mbrëmjen e 27 shkurtit, kryesia e shtetit miratoi "marrjen e masave të veçanta për Kosovën". Dhe këto "masa të veçanta" nuk ishin gjë tjetër veçse gjendje e jashtëzakonshme.

Më 28 shkurt, (pasi Rr.Morina, H.Azemi dhe A.Shukria kishin ofruar dorëheqjet e kërkuara nga minatorët), minatorët dolën nga greva, por ky trinom millosheviçjan realisht nuk u largua nga fuksionet e tyre!

Më 9 mars 1989 Kuvendi i Kosovës nxori dy konkluzione: 1.Të përkrahen masat e posaçme (lexo: Gjendja e jashtëzakonshme) të Kryesisë së RSFJ'së për Kosovën; 2. Miratimi i amandamenteve në Kushtetutën e Serbisë është me rëndësi të posaçme, jo vetëm për Krahinën dhe RS të Serbisë, por edhe për mbarë stabilizimin e Jugosllavisë dhe se këto amandamente duhet të miratoheshin me kohë".

Më 14 mars 1989, dy kryesitë e Kosovës, (ajo e Komitetit Krahinor dhe e Kryesisë së Kosovës), përmes një kumtese të përbashkët, theksojnë, se: "Dy kryesitë përkrahin plotësisht amandamentet për Kushtetutën e RS të Serbisë, me të cilat mundësohet që RS e Serbisë të ushtrojë funksionet dhe kompetencat e veta të domosdoshme në tërë territorin e Republikës…" dhe se, me "këto ndërrime nuk ndryshohen parimet themlore të Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974 dhe pikënisje është realizimi i konsekuent i barazisë së plotë kombëtare të të gjitha kombeve e kombësive në RS të Serbisë dhe në KSA të Kosovës".

Më 21 mars, Këshilli Ekzekutiv i Kosovës i propozoi Kuvendit të Kosovës që në Mbledhjen e caktuar për datën 23 mars të jepte pëlqimin për amandamentet në Kushtetutën e Serbisë. Më 23 mars 1989, (ditë e enjte), në Pristine, në orën 10 paradite u mblodhën delegatët e të tri dhomave të Kuvendit të Kosovës:

1. Dhoma e Punës së Bashkuar, me kryetar Raif Vërbnica;

2. Dhoma e Komunave, me kryetar Radoica Zhizhiq dhe

3. Dhoma Shoqërore - Politike, me kryetar Shefqet Mustafa.

Në sallën e Kuvendit të Kosovës kishte mbi 500 njerëz, funksionarë, punëtorë të sigurimit, mysafirë nga të gjitha komunat e Kosovës dhe nga Serbia, ndërsa ishin 190 delegatë të zgjedhur, qysh në nëntor të vitit 1988 nga komisionet kandiduese të të gjitha organizatave shoqërore - politike. Në këtë mbledhje të përgatitur nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Vukashin Jokanoviq, diskutuan 27 delegatë, 20 shqiptarë dhe 7 serbë, dhe në fund u aprovuan me aklamacion (ngritje të dorës) amandamentet e Kushtetutës së Serbisë. Ishin 11 vota kundër dhe dy abstenime, ndërsa numri i votave "për" nuk u mësua kurrë, sepse nuk u numruan nga kryetari i Kuvendit. Nga pamjet në ekranin e RTP dhe fotografitë që u publikuan në shtypin e përditshëm, duket qartazi se pjesa dërmuese e atyre që kishin ngritur dorën nuk ishin delegatë! Pasditen e 23 marsit, (pasi u aprovuan ndryshimet kushtetuese në Kushtetutën e Serbisë nga Kuvendi i Kosovës), shpërthyen protesta të fuqishme e të pandalshme në gjithë Kosovën, deri më 28 mars, kur në Beograd u finalizua miratimi i Kushtetutës së RS të Serbisë. Ndërsa në Beograd festohej "Serbia unike" dhe "Dita e ribashkimit" të saj, rrugët e Kosovës u përgjakën nga njësitë speciale të Serbisë. Nga 23-28 mars u vranë 22 shqiptarë dhe u plagosën rëndë rreth 300 të tjerë…

Bac, e bëra këtë hyrje për të përkujtuar periudhën më të rëndë historike nëpër të cilën kaloi Kosova dhe populli shqiptarë. Si i kujtoni Ju këto kohë delikate për shqiptarët?

Idriz Mehmeti: Po, më kujtohen shumë mirë ato ngjarje të vështira. Ishte nëntori i vitit 1988, kur minatorët e Trepçës filluan protestën e parë, duke marshuar në këmbë nga Mitrovica deri në Prishtinë, për ta mbrojtur edhe atë pak autonomi që kishte Kosova, në bazë të kushtetutës së vitit 1974. Si në gjithë Kosovën, edhe në Drenicë u organizuan protesta. Në këtë situatë edhe unë dhashë kontributin tim në masivizimin e këtyre protestave! Pata shkuar në këmbë deri në Prishtinë. Një ditë bashkëfshatari im, Rizah Sylejman Rexhepi, duke biseduar për protestat dhe përkrahjen që i duhej dhënë të rinjëve në këtë drejtim, më tha se kjo rini mësuesin e kanë të fortë, punon në fabrikën tonë, është shumë i përgatitur dhe i zoti!

E pyeta, kë e kanë mësues?

Hamëz Jasharin - më tha - është i vëllai i atij me mustaqe të mëdha (Adem Jasharit - sh.b). Ishte Hamëz Jashari, mësuesi i këtyre djemve, që organizonin në Skënderaj protesta kundër planeve të errëta serbe! Ishte i biri i mësuesit, Shaban Jashari, i cili, jo vetëm djemve, nipave e mbesave të tij, por edhe nxënësve do t'ua mësonte historinë e dhimbshme të popullit shqiptar që s'shkruhej në librat shkollore. Pra në krye të grupit që organizonte protesta në Skënderaj ishte Hamëz Jashari, i cili nuk ekspozohej shumë në publik. Ndërsa në Drenas ishte Xhevë Krasniqi (Lladrovci) dhe shumë djem e vajza të shkollave të mesme, disa prej tyre edhe i njihja. Në protesta u dalluan: Adem Jashari, Jakup, Halil e Adem Nura, Shemsije Istogu (Lladrovci), Fatmira Musliu, Ramiz e Sabit Lladrovci, Eset e Fatmir Istogu, Xhelil Smajli, plaku Shefqet Smajli nga Qirezi, disa të rinjë nga Krajkova e Drenasit, nga Klina e Skënderajt, e fshatra të tjerë.

Sheradin Berisha: *Kur u njohët për herë të parë me Adem Jasharin dhe familjen e tij?*

Idriz Mehmeti: Në Pranverën e vitit 1989, së bashku me Jakup e Adem Nurën, (nipin tim), kemi shkuar në kullën e Jasharajve në Prekaz, dhe për herë të parë e kam njohur nga afër Bacën Shaban, Ademin, Hamzën, dhe bacin Rifat. Jakup e Adem Nura kanë qenë bashkëluftëtarët e parë të Adem Jasharit. Këta të dy kanë qenë të pandashëm. Nga vizita ime e parë në kullën e tyre, e deri në rënien heroike të Ademit, në mars 1998, kurrë më nuk i kam shkëputur kontaktet me Ademin. Jemi takuar në raste e vende të ndryshme: në Skënderaj, në shtëpinë e tij, në shtëpinë time, në shtëpinë e Jakup Nurës, në shtëpinë e Man Veliqit etj.

Sheradin Berisha: *Si e kujtoni Adem Jasharin?*

Idriz Mehmeti: Adem Jashari, kishte disa karakteristika të veçanta, të cilat e bënin të dallohej nga bashkëmoshatarët e tij. Kjo veçanti ndoshta ka lidhje me vendlindjen e tij, Prekazin e Ahmet Delisë, të Emin Latit, të Nebih e Tahir Mehës; ishte gjak i Azem Galicës. Ai ishte fjalëpak, por

kur fliste ishte i prerë, ishte i rreptë. Pastaj dallonte me ecjen e tij, me mustaqet karakteristike, dhe mbi të gjitha me aftësitë që kishte në përdorimin e armëve! Nëse nuk e njihje nga afër, pamja e tij të lente përshtypjen e një njeriu të ashpër, por kur e njihje, e kuptoje se ishte njeri i urtë, i ndershëm, i sinqert, i vendosur, dhe i gatshëm për gjithçka. Nga pamja fizike i ngjante shumë Çerçiz Topullit? Ky ishte Adem Jashari!

Sheradin Berisha: *Gjatë kësaj kohe a kishe takime me Adem Jasharin?*

Idriz Mehmeti: Po. Po tregoj një rast. Gjatë një pasditeje Adem Jashari, bashkë me Jakup e Adem Nurën vijnë për vizitë në shtëpinë time. Por vizita ishte e qëllimshme! Ishte fundjavë, dhe zakonisht "Radio Televizioni Shqiptar" shfaqte filmat e "Kinostudios Shqipëria e Re". Oda jonë, kur shfaqeshin filmat shqiptarë, gjithnjë ishte e mbushur me mysafirë. Mbaj mend, shfaqej filmi "Flaka e Maleve", dhe të gjithë të pranishmit përcillnim zhvillimin e ngjarjeve në film me përqëndrimin më të thellë. Secila sekuencë filmike, secila fjalë e thënë nga burrat e moçëm, përmes fjalës artistike, për neve kishte një peshë të madhe. Kohët po përsëriteshin, vetëm "aktorët" ishin të ndryshëm. Dhe pikërisht kjo ngjashmëri, ky tufan zjarresh e luftërash të njëjta, shtonte edhe më shumë kureshtjen tonë për ato ngjarje historike që përcillte përmes artit "Radio Televizioni Shqiptar" i asaj kohe, në odat tona. Aktori që luante rolin e Binak Prelës, kishte mustaqe të mëdha, dhe kishin një ngjajshmëri, gati epike, me mustaqet e Adem Jasharit! Në një moment, babai im për ta ngacmuar, e pyeti: a thua i ka mustaqet e veta apo i ka të ngjitura ky burrë?! Ademi buzëqeshi, e u përgjigj: "Kështu si unë, edhe ai i ka të ngjitura!" Ndërsa mua më pëshpëriti lehtë me buzëqeshje në vesh: "Plakut po i duken havalele mustaqet, s'ka faj".

Pasi mbaroi filmi, të afërmit e kushërinjtë u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre. Ademi nxori nga xhepi një numër të gazetës "Zëri i Kosovës" dhe ma dha në praninë e babait dhe të vëllezërve të mi. E shfletuam faqe për faqe dhe, përveç tjerash, lexuam edhe artikullin për qëndresën heroike të Rexhep Malës nëpër burgjet serbe. Ademi fliste me shumë admirim për

të burgosurit politikë, veçanërisht për Adem Demaçin e Rexhep Malën, por nuk e lëshonte nga goja në asnjë rast Tahir Mehën. "Kështu bien vetëm burrat e fortë" - thoshte ai!

Meqenëse bashkëpunoja me disa shokë të ilegales, kisha disa numra të "Zërit të Kosovës", që m'i sillte nga Zvicra vëllai, Halili. Shkova aty ku i mbaja të fshehur me ca komunikata, që aso kohe botoheshin në Zvicër, e zgjodha një numër, ku në ballinë kishte Hydajet Hysenin me megafon duke iu drejtuar demonstruesve, (në demonstratat e vitit 1981 në Prishtinë), dhe ia dhashë Ademit. Kështu i patëm shkëmbyer dy numra të së njëjtës gazetë. Pas darke, dikur vonë, i përcolla deri në fund të fshatit; të tre kishin revole me vete. Ademit i thashë: a mund ta siguroni edhe një për mua! Po, tha ai, si jo, por koha po u vjen "të gjatave"! Dhe vërtetë nuk vonoi e koha u erdhi "të gjatave".

Sheradin Berisha: *Meqë përmendët armët e 'gjata'... e siguruat këtë armë që ia kërkuat Adem Jasharit?*

Idriz Mehmeti: Po, në vitin 1991, me porosi të Adem Jasharit, së bashku me Man Veliqin, (dhëndrrin e tij), patëm shkuar në një bazë, në Vaganicë, afër Mitrovicës dhe e blemë një pushkë automatike, me të cilën, pas largimit tim nga Kosova, në fillim të 1997-ës, vëllai im, Besimi, do t`i bashkohej Adem Jasharit. Pastaj në vitin 1998 do të sistemohej në pikën "Arra", të ngritur nga Jakup Nura, në fshatin Prellovc.

Sheradin Berisha: *Tashmë ju e njihnit nga afër Adem Jasharin, por, a i njihnit edhe shokët e tij të armës?*

Idriz Mehmeti: Si jo, disa nga shokët e Ademit, i njihja personalisht, si: Jakup, Adem e Halil Nurën nga Prellovci i Skënderajt, Fatmir Istogun nga Palluzha, Fadil Xhokën nga Tërsteniku i Drenasit, Xhelil Smajlin nga Qirezi, Avni Ramën nga Klina e Ultë e Skenderajt, Sahit e Musë Jasharin, Ilaz, Fadil e Zenun Kodrën, pastaj Sami e Nuredin Lushtakun, Besim e Rafet Ramën, të gjithë këta nga Prekazi. Ademi më kishte thënë se kishte edhe disa shokë të tjerë nga rrethe të ndryshme të Kosovës, si nga Mitrovica, Vushtrria, Podujeva, Deçani etj. Por ai kishte shokë edhe jashtë Kosovës. Shumë herë më kishte folur se këta djem janë të gatshëm e të zotët për detyra të kohës. Nuk do të shkonte gjatë dhe ai do të fillonte organizimin e ushtrimeve ushtarake, do të kontaktonte me disa nga drejtuesit e LDK-së në Perëndim. Kështu ai do të kalonte realisht

nga e thëna në të bërë. Tani nuk e di në detaje gjithë rrjedhën e organizimit, por ajo që di unë, e për çka në shumë raste më ka folur vet Ademi, se bartës të organizimit të atyre ushtrimeve në Shqipëri ishin disa aktivist të LDK-së në Perëndim, por ishin në dijeni edhe disa drejtues të lartë të LDK-së në Prishtinë. Ai shpresonte se kishte arritur ta realizonte dëshirën e djemve që ishin të gatshëm të vepronin në dy vija njëherësh: ilegalisht, dhe legalisht.Thjeshtë, besonte në kombinimin e veprimeve. Vend kishte për të dyja alternativat e kohës,. Megjithatë, me kalimin e kohës, elementi kryesor i njërës palë do të mungonte, (në këtë rast i legalistëve), mungonte vullneti dhe morali qytetar, mungonte përgjegjësia njerëzore dhe kombëtare gjithsesi.

Sheradin Berisha: *Bac, më lartë përmendët përciptazi organizimin e ushtrimeve në Shqipëri. A mund ta konkretizoni këtë aktivitet, kur dhe si u organizuan këto stërvitje në Shqipëri?*

Idriz Mehmeti: Në vjeshtën e vitit 1991 u organizuan stërvitjet ushtarake në Shqipëri. Dihet tanimë botërisht që këto stërvitje me peshë jetike për fatin e Kosovës, filluan dhe u zhvilluan me lejen e ish Presidentit të Shqipërisë, Ramiz Alia. Meqë unë nuk isha pjesëmarrës në këto stërvitje, nuk do të ndalem në detaje të këtij aktiviteti, por di që, disa nga pjesëtarët e këtyre grupeve ishin kthyer përsëri dhe ishin akomoduar në shtetet perëndimore, kryesisht në Gjermani dhe Zvicër. Çuditërisht, ata njerëz u shfaqën e u rishfaqën kur lufta kishte përfunduar! Folën e folën, vetëm me të vdekur e për të vdekur, por asnjëherë me saktësi nuk e thanë të vërtetën.

Sheradin Berisha: *E mbaj mend edhe unë këtë kohë! Kishte shumë fjalamanë të tillë, por Adem Jashari nuk doli asnjëherë jashtë - në shtetet perëndimore, ai ka vazhduar aktivitetin në Kosovë. A ishte kështu apo jo?*

Idriz Mehmeti: E saktë. Adem Jashari, në atë kohë të rëndë e të zymtë për vendin, me një pjesë të mirë të grupit, ishin ngarkuar me teknikë luftarake dhe ishin futur në Kosovë. Me të arritur në Drenicë, më lajmëroi përmes nipit tim, Adem Nurës, që ka ardhur shëndoshë e mirë.

Shkova dhe e vizitova, sipas porosisë. Ishte shumë i kujdesshëm. Megjithatë, ndonjëherë dilte dhe takoheshim edhe në Skënderaj. Më kujtohet një rast tek pinim kafe, dhe unë për ta ngacmuar, (e dija që i kishte revolen dhe dy bomba në brez), i bëra këtë pyetje shoqërore: "Po sikur të vijë policia të na legjitimojë, ç'do bësh me ato 'ngarkesa' që i ke rreth brezit?" Ai lëshoi një buzëqeshje të ngrohtë dhe iu përgjigj seriozisht shakasë sime: "Sigurisht që do t'u përgjigjem policëve - tha, - por meqë Kosova më ka dhënë vetëm këto 'letërnjoftime' të brezit, dije pra që secili polic, që do të provojë fatin të më kërkojë tjetër dokument nga unë, do t'ia mbush gojën me bomba"... Dikur më vonë, e mori vesh gjithë bota, se Ademi ishte një Adem i papërsëritshëm.

Sheradin Berisha: *Bac, në fillim të viteve '90 (përveç LDK-së), u formuan shumë parti politike në Kosovë. Ju a u organizuat në ndonjë subjekt politikë?*

Idri Mehmeti: Po, asokohe isha një aktivist shumë i përkushtuar i LDK-së, dega në Skënderaj, megjithatë, Adem Jashari kishte besim të plotë tek unë. Jam shumë i lumtur që nuk e kam zhgënjyer asnjëherë. Gjithmonë më dhemb shpirti që nuk i kisha mundësitë, që krahas dëshirës, t`i jepja mbështetjen e duhur që kërkohej.

Sheradin Berisha: *Të ndalemi te një moment shumë i rëndësishëm për rrjedhat e mëtejshme të rezistencës së armatosur! Pas stërvitjeve ushtarake në Shqipëri, (në vjeshtën e vitit 1991), theksuat se, Adem Jashari i "ngarkuar me teknikë luftarake" hyri në Kosovë. Por nuk zgjati shumë kohë, dhe pikërisht më 30 dhjetor të atij viti, forcat serbe e sulmuan familjen e Adem Jasharit në Prekaz të Poshtëm. Ku ishit në këtë kohë, dhe si e kujtoni këtë ngjarje?*

Idriz Mehmeti: Më kujtohet shumë mirë kjo ngjarje, e cila vërtetë i përcaktoi "rrjedhat e mëtejshme të rezistencës së armatosur". Ishte 30 dhjetori i vitit 1991. Bashkë me djalin e dajës tjetër, Hajzerin e dajës Islam ishim mysafirë në Drenas tek daja im, vëllai i nënës, Ali Dobra. U zgjuam në mëngjes dhe u nisëm për në punë: unë punoja asokohe në Fabrikën e Feronikelit, ndërsa ai ishte mjek në ambulancën e fshatit

Tërstenik. Posa dolëm në rrugë pamë dy autoblinda, të cilat shkonin me shpejtësi të madhe në drejtim të Skënderajt. Dajë i thashë: Këta ja paskan mësy Prekazit! Jo more! - tha, po thu a? - Po i thashë!.. Isha i sigurt.

Nuk shkova në punë. Dola të shoh se mos po lëviz diçka në drejtim të Skënderajt. Për çudi, nuk vonoi shumë dhe me autobusin e Kosovatransit arriti Zeqë Veliqi, (vëllai i Man Veliqit, dhëndrrit të Jasharajve). Thua se ishte krejt i humbur.

"Idriz! - ë tha, mbaroi familja e Shaban Muratit, luftë!, tha. - Jasharët po luftojnë me Serbi, njofto edhe ti cilin të mundesh se u ndez". Kam shkuar me të deri te Lisat e Xanit, si i themi ne hyrjes në fshatin Polac, e pastaj kam vazhduar në këmbë drejtë Prekazit. Të parët që kam takuar ishin: Man Veliqi e Gani Koci, aty afër lagjës së Lushtakëve, në një pyll. Ata më treguan se Ademi dhe të tjerët e kanë çarë rrethimin dhe janë këtu afër, në pyll. Pas pak kohësh i takova Ademin dhe Jakup Nurën. Meqë ishte kohë me borë, ishin mbështjellur me çarçafë të bardhë që të mos i dallonte helikopteri, i cili gjatë gjithë kohës fluturonte mbi Prekaz. Kam biseduar me ta dhe i kam propozuar Ademit të tërhiqen në drejtim të Qyqavicës, dhe në mbrëmje të vijnë tek unë në shtëpi, se kisha vend për strehim të përkohshëm.

"Po, mirë të shohim, nëse vi, do të vi me tërë grupin" - më tha.

"S'ka problem - i thashë, - e kemi odën. Ti e di këtë, kur mora vesh që je rrethuar, s`kam besuar që do të shoh më. Nuk e merrja me mend si do të gjendem nesër kur të vijë e t`i ngre lart dy gishta për ty!"

Ai duke qeshur më tha: "Shko, merre pushkën e kthehu se lufta filloi".

Jam përshëndetur me ta dhe jam nisur në drejtim të fshatit, drejt shtëpisë sime. Në rrugëtim e sipër kam takuar edhe shumë njerëz të njohur e të pa njohur, me armë e pa armë. Në shtëpi i kisha dy pushkë, dhe thashë me vete, erdhi dita e tyre. Ishte borë e madhe dhe mezi arrita në shtëpi pak para mbrëmjes. Isha i rraskapitur nga lodhja. Vendosa të pushoj e të

nesërmen herët të shkoj e t`u bashkohem Ademit me shokë. Mirëpo, vonë në mbrëmje mësova për tërheqjen e forcave serbe. Prita se mos po vijnë edhe ata, siç ishim marrë vesh me Ademin e Jakup Nurën, por nuk erdhën. Të nesërmen mësova se, ata në mbrëmje vonë kishin shkuar në shtëpinë e Gani Kocit, kishin pushuar aty dhe pas konsultimeve që kishin pasur me Jakup Krasniqin e Gani Sylën, kishin shkuar në Obri të Skënderajt, tek Ilmi Zeka, e më vonë tek Jakup Krasniqi në Negrovc të Drenasit.

Në Negrovc do të qëndrojnë disa ditë, herë në Shtëpinë e Jakup Krasniqit, herë në Shtëpinë e Shaban Salës, derisa do të organizohej përcjellja e bacit Rifat Jashari për në Shqipëri. Organizimin e kishin bërë në mënyrë të përkryer: Jakup Krasniqi, Azem e Gani Sylaj, Shaban Shala e disa të tjerë që unë nuk i njihja.

Sheradin Berisha: *Bac, para se të vazhdoni më tutje me rrëfimin e kësaj ngjarjeje historike, të ndalemi pak te përcjellja e Bacit Rifat për në Shqipëri! Në Prizren, (si në çdo qytet të Kosovës dhe në viset tjera shqiptare në ish-Jugosllavi), vepronte organizata ilegale, Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). LPRK-ja (nga korriku 1993 LPK-ja), ku bëja pjesë edhe unë, gjatë viteve 1990-1993, ka dhënë kontribut të veçantë në futjen e armatimit nga Shqipëria në Kosovë, për armatosjen e grupeve të para që vepronin në kuadër të Lëvizjes... Atëkohë ka pasur disa vija të furnizimit me armë, dhe njëra prej tyre ishte vija: Kukës - Koretnik - malet e Zhurit - Vërri, (Kushtrim (ish-Billushë), Hoçë e Qytetit, Lagjja Bajram Curr, Lagjja Tusus dhe Lagjja Arbanë të Prizrenit) - Rahovec - Therandë - Drenicë. Përmes kësaj rrugë, ne anëtarët e Lëvizjes, i kemi strehuar përkohësisht dhe pastaj i kami përcjellur ilegalisht për në Shqipëri edhe shumë veprimtarë të rrezikuar nga regjimi pushtues serb. Dhe njëri prej shokëve të rrezikuar ishte Rifat Jashari. Disa ditë pasi kishte ndodhur sulmi në familjen e Jasharëve në Prekaz, (ashtu siç e shpjeguat ju), bacin Rifat nga Negroci ku ishte i strehuar, Jakup Krasniqi me shokë e kanë sjellur në Lagjen Arbanë (ish-Dushanovë) të Prizrenit te veprimtari i Lëvizjes, Alush Shala. Baci Rifat qendroi disa ditë i strehuar në shtëpinë e Alushit dhe te*

disa shokë të tjerë dhe pastaj, përmes tyre, dorë më dorë, nga hyrja e fshatit Hoçë e Qytetit kam pas nderin ta shoqëroj unë, deri në hyrje të fshatit Zhur, (te Stadiumi i fshatit). Në këtë vend Bacin Rifat, sipas konsultimeve paraprake (me Ismet Badallajn), ia kam dorëzuar dy veprimtarëve, Seadin Gavazaj dhe Rifat Ajazaj, të cilët pastaj në Zhur ia kanë dorëzuar veprimtarit Ismet Badallaj.

Baci Rifat këtë ngjarje e rrëfen në detaje edhe në emisionin "Pa rrotlla", në vitin 2013. Ai me këtë rast thotë:

"Unë kam nej edhe ni javë në Prizren, te Alush Shala, tani prej Alushit te Sefa, prej Sefës te Zeadini, te Ysnia - në 4 familje qaty jam end sa me hup kohën. Tani me ndihmën e tyne, me kanë ndimue ata për me thy kufinin. Ata me kanë përcjell ni pjesë (të rrugës), aty më ka prit nji tjetër, që sot e kësaj dite nuk e di kush kanë qenë, se i kanë pas emrat e kodum. (Kam qenë unë -Sheradini, Seadin Gavazaj dhe Riat Ajazaj - sh.b). Megjithse nuk e kam pas marak me vet njerin, as sot nuk ia veti fort biografinë. Jemi shku në Zhur. A kanë Ismet Badalli, na ka çu te baballëku (gjyshi) i vet. Aty kemi hangër, kemi pi. Vjerra e tina (e Ismetit) mi ka mshtjell kamët me flet të laknës, se m'u patën aj kamët, m'u patën ba qekaq, se kesh dal dathët. Dhe a kanë ni Azemi, ai asht vra në kufi, dhe na ka pri me thy kufinin shqiptaro - shqiptar. Prej atyit në Kukës, në Kukës e kishin pas një epror ushtarak, se kishin pas lidhje me ta. Na ka marrë e na ka çu në familje, kemi nejt dy ditë aty, dhe e kemi lan ni parullë me Ademin, kur ta thej kufinin me shku në Kukës me përshendet Prizrenin dhe Drenicën. Bile keshi ajo çika që punojke aty, për herë të parë - tha - po më ndodh qe kjo, po me befason - me përshëndet edhe Prizrenin edhe Drenicën. Çka ka këtu? Kurgja, qashtu. Demek me ju tregu që shnosh e mirë kemi dal m'atë anë. Tani kum shku në Tiranë mas dy dite, Zvicër, prej Zvicrre në Gjermani, edhe deri në 96-shtën ma nuk e kum shkel Prekazin…". (Ky rrëfim i Rifat Jasharit mund të shikohet në video, nga minuta 19:15 - 21:23. "Pa rrotlla" - Rifat Jashari: https://www.youtube.com/watch?v=9RbjPhK3kz8

***

Tani Bac, vazhdoni aty ku mbetët, te rrugëtimi i Adem Jashatit me shokë…

Idriz Mehmeti: Pastaj ata (Ademi më shokë - sh.b) do të kalonin e do të strehoheshin për një kohë më të gjatë në shtëpinë e Jakup Nurës, në Prellovc të Skënderajt. Diku, në fillim të shkurtit 1992, patën ardhur tek unë, Ademi, Hamza e Sahit Jashari, të shoqëruar nga nipi im, Adem Nura. E kishim të lirë odën e kushëriut, Xhemë - Mexhri Mehmetit. Paraprakisht kisha biseduar me të. Ai më pati thënë: "Ti e di që unë nuk kam kushte t'i mbaj me ushqime e me gjëra të tjera, por nëse i merr, i mban dhe kujdesesh ti për ta, oda është e juaja". E falënderova shumë Xhemën, dhe i vendosëm në odën e tij, me shpresë se do ta kalojnë gjithë dimrin aty. Por pas dy ditësh kishte hyrë pa dijeni një djalë i ri (Mexhidi i mixhës Qerim) në odë, dhe meqë ishte shumë i ri, nuk i besohej, u detyruam t`i tërheqim dhe t`i kthejmë përsëri tek Jakup Nura, në Prellovc. E di se te Jakup Nura kanë qënduar një kohë të gjatë, gjithashtu te Man Veliqi, në Polac, e tek Haxhi Halimi; te babai i Januz e Ramadan Gashit, në Kryshevc. (Januzi e Mani ishin dhëndurët e Jasharajve).

Gjithnjë ishin në kontakt me Plakun, bacën Shaban e familjen. Kohë pas kohe qëndronin në shtëpinë e tyre, por fillimisht me disiplinë vërtetë të ilegalitetit të thellë, e më vonë vendosën që të mos i shmangen ballafaqimit me milicinë serbe. Pothuajse nuk fshiheshin fare. Në çdo çast, me tërë armatimin që kishin, ishin të gatshëm të përballeshin me forcat serbe. Kështu filluan të bëjnë jetë gjysëmilegale. Ditën me armë në dorë, natën me armë nën kokë. I kam vizituar gati çdokund ku qëndronin, (në vendet që më parë i përmenda), asnjëherë nuk janë fshehur prej meje.

Sheradin Berisha: *Pas sulmit në Prekaz, - thatë që - Adem Jashari me shokë po bënte jetë gjysëmilegale dhe ju madje keni vazhduar të mbanit kontakte me të! A mund të veçoni ndonjë ngjarje me rëndësi që ka ndodhur gjatë kësaj kohe?*

Idriz Mehmeti: Po, kam bërë një udhëtim të veçantë me komandantin Adem Jashari. Ishte fillimi i Marsit 1992. Me porosi të Komandant Adem Jasharit, në shtëpin time vjen nipi Adem Nura. "Dajë, - tha - Adem Jashari më ka porositur: nëse je i lirë dhe ke mundësi, merre makinën dhe eja në Prekaz, se do të udhëtojmë diku."

Isha i lirë dhe menjëherë u nisëm bashkë me Adem nipin, shkuam në Prekaz. Kërkesa e Komandantit ishte: ta gjejmë diku një telefon. Donte të komunikonte me Bacin Rifat dhe me disa individë në Gjermani e në Zvicër, (me ata që ishin marrë me organizimin e stërvitjeve ushtarake në Shqipëri). "Nëse je i gatshëm të na pranosh të armatosur në makinë, dhe të na dërgosh te ndonjë i njofshëm që ka telefon, ta di shumë për nder - tha. Por më kupto, e mos më keqkupto, unë nuk marr rrugë kurrë pa armë! Ti e di si i kemi punët".

Jam menduar një çast, ku të gjenim telefon e mos të rrezikohemi!

Atëherë s`kishte celularë, e telefona shtëpie gjendeshin rrallë, edhe ato vetëm në qytete. Të vetmen mundësi e kishim në banesën e djalit të axhës, Xhezairit, në Drenas. Por ai banonte në një hyrje me një të mjerë që akoma punonte si shef në milicinë serbe, në Drenas. Mundësi tjetër nuk kishim.

I shpjegova Ademit në hollësi.

Ai tha: "Kërkund më të sigurtë nuk jemi; veç pyete djalin e axhës, se unë nuk e kam problem..."

S`kisha aspak nevojë ta pyesja djalin e axhës, shtëpia e tij ka qenë gjithmonë edhe e imja. Kështu u vendos, u bë plani dhe u nisëm në mbrëmje kur u terrua. Nga Prekazi (nga shtëpia e tij), nëpër Polac, dhe vazhduam drejt Drenasit. Në hyrje të Drenasit, tek vendi i quajtur "PIK-u", shpesh rrinte milicia serbe me autoblindë. Ishim marrë vesh paraprakisht që, nëse do t'na ndalnin, unë do të jepja shenjë kinse po ndalem, dhe kur të afrohen për t'na legjitimuar, Adem Jashari, Jakup e Adem Nura, do të hapnin zjarr. Detyra ime në ato çaste ishte manovrimi

i mirë me timonin. Për fatin tonë, policët kishin qenë brenda në autoblindë dhe nuk na ndaluan fare. Kam ngarë makinën me kujdes dhe kemi arritur para banesës së axhës tim; e kemi parkuar makinën dhe jemi ngjitur lart pa na diktuar askush.

Ademi mori telefonin dhe, përveç bacit Rifat në Gjermani, e thirri edhe Imer Berishën në Zvicër. Ka biseduar gjatë me ta. Pos të tjerash e kam dëgjuar duke e pyetur njërin nga këta: "Kush na qiti neve, që po na lypin me listë?"; pyeste pra, se kush i zbuloi, milicia serbe po i kërkonte me listë, pas kthimit nga Shqipëria. Si i mbaroi bisedat, kemi ngrënë darkë, kemi pirë çaj dhe jemi kthyer prap në Prekaz. Në të kthyer, për shkaqe sigurie, nuk kaluam pranë autoblindës, kemi shfrytëzuar një rrugë tjetër alternative, dhe kemi vazhduar nëpër Çikatovë, Gllanasellë, Likoshan, Qirez, Polac, dhe arritëm në Prekaz. E kemi lënë Komandantin në shtëpin e tij, dhe i kam çuar në shtëpitë e tyre në Prellovc Jakup e Adem Nurën. Gjithë jetën time do ta kujtoj me kënaqësi këtë udhëtim me komandantin.

Sheradin Berisha: *Bac, atëkohë partitë politike, gjegjësisht LDK-ja, saktësisht i kreu i kësaj partie ishte përcaktuar që zgjidhja e çështjes së Kosovës të bëhet në mënyrë "demokratike" edhe pse Kosova ishte e pushtuar në çdo pore të jetës. Madje kryetari i LDK-së, Ibrahim Rugova, në konferencat e të premteve me gazetarë bënte thirrje për "qetësi" dhe kërkonte vazhdimisht, që "të mos provokohet situata", sepse sipas tij ishte krijuar një "rend demokratik në Kosovë"!!! Pas sulmit të fund-dhjetorit 1991 në familjen e Jasharajve në Prekaz, por edhe më vonë, (deri në mars 1998), në opinionin tonë publik qarkullonin shpifje të ndryshme kundër Adem Jasharit, dhe njëra prej tyre ishte se: "Adem Jashari është njeri i Serbisë". Pra, kishte nisur një fushatë e egër kundër njësisë së aramatosur në krye me komandantin, Adem Jashari. Cili ishte qëllimi dhe çka synohej me këtë propagandë ndjellakeqe?*

Idriz Mehmeti: Keni të drejt! Çuditërisht, pas sulmit të 30 dhjetorit 1991, i cili në kujtesën historike mund të vlerësohet si pushka e parë kryengritëse e Ademit me shokë, kundër pushtuesit, jo vetëm që nuk pati

përkrahje nga LDK-ja në Prishtinë, por pa asnjë dozë turpi, filloi një farë presioni me qëllim që Ademi më shokë ta lëshonin Kosovën, kinse përkohësisht, ngase "akoma nuk ishin pjekur kushtet për fillimin e rezistencës së armatosur". Pra, Prishtina vuri në lëvizje të gjitha mjetet për sabotimin e kryengritjes! Mirëpo, Ademi e kishte kuptuar se hilja nuk ishte e përkohshme, ndaj shkurt dhe qartë kishte refuzuar largimin nga Kosova.

Pasi Adem Jashari e kishte refuzuar, kërkesën e Prishtinës, të Lidhjes Demokratike të Kosovës, më saktë të kreut të kësaj partie, për t'u larguar nga Kosova, mori hov një fushatë tjetër. Filluan, pa fije turpi të lansohen shpifje nga më të ndryshmet. Madje shkohej edhe aq larg sa që thuhej, se: "Serbia nuk dashka vet t`i arrestojë,... me qëllim i len të lirë që të arsyetojë dhunën dhe krimet e policisë së vet mbi shqiptarët…". O Zot! o Zot! cilin e vrau turpi gjer më sot, që t`i vrasë, së paku zërat e kobshëm që mbillnin kob! Dihen kufijt e njerëzores, por ama kufij turpi askush akoma nuk ka gjetur!

Sheradin Berisha: *Derisa LDK-ja në Prishtinë bënte sehirxhinë kundër Adem Jasharit, po në Drenicë, a kishte përkrahje atje…?*

Idriz Mehmeti: Po, kishte shumë! Me qëllim që të paralizoheshin spekulimet e shpifjet e tilla, kemi shkuar haptasi me kryetarin e atëhershëm të LDK-së, Idriz Rrecin, (i cili për mendimin tim ishte një burrë i ndershëm), dhe e kemi vizituar Ademin me shokë. Ademin e kanë vizituar edhe Gani Koci, Ramadan Gashi, Bedri Deliu, Murat Musliu, Enver Haliti, Gani Thaçi, Bislim Bajrami. E kanë vizituar edhe disa anëtarë të degës së LDK-së nga Drenasi, si: Jakup Krasniqi, Gani Sylaj, Shaban Shala me Ilmi Zekën e Ramiz Lladrovcin etj. Më duhet gjithashtu të theksoj se Ademi e vlerësonte shumë mendimin politik të Jakup Krasniqit.

Pra, Ademi me shokë s`ishte i vetmuar, kishte përkrahje të gjithanshme nga shokë dhe miq, që mendonin si ai dhe që më vonë iu bashkuan radhëve të lavdishme të UÇK-së. Mirëpo, ne si banorë të Skënderajt, ishim më shumë të obliguar që t`u qëndrojmë afër Ademit me shokë. Një

rast, vetëm gjatë një dite i kemi mbajtur tri takime në tri lagje të Prekazit të Ultë (tek Jasharajt, Lushtakët dhe Kodrajt). Qëllimi ishte t`u bëhej me dije njerëzve, se këta djem duhen përkrahur e jo të përgojohen, që të kenë kujdes e të mos bien pre e spekulimeve të ndryshme.

Sheradin Berisha: *Bac, folëm për aktivtetin tuaj brenda në Kosovë, dhe veçanërisht për organizimin armatosur të Adem Jasharit. Gjatë viteve 1989-1993 a keni shkuar ndonjëherë jashtë Kosovës. Ta zëmë, a e keni vizituar ndonjëherë Shqipërinë?*

Idriz Mehmeti: Po, gjatë vitit 1992 e kam vizituar dy herë Shqipërinë?

Sheradin Berisha: *Cili ishte qëllimi i vizitës suaj në Shqipëri?*

Idriz Mehmeti: Për herë të parë në Shqipëri kam shkuar në maj - qershor të vitit 1992. E njoftova edhe Ademin! "Shumë mirë!" - tha - dhe më porositi që ta vizitoj 'Përfaqësinë e Kosovës' në Tiranë, Dr.Ali Aliun dhe Zymer Berishën, ngase përveç që punonin në këtë zyrë, ata ishin marrë edhe me organizimin e stërvitjeve ushtarake gjatë vitit 1991.

Në Shqipëri shkova me Haki Salihun nga Baksi, (Hakiu ishte djali i hallës sime), dhe Agim Halimin nga Qirezi. Kufirin e kaluam te vendi 'Banjat e Banjishtës', siç quhej një kodër afër Dibrës së Madhe, dhe fillimisht jemi futur në fshatin Klloboçicë. Meqë nuk e njihnim terrenin, u ndaluam nga forcat kufitare të Shqipërisë. Mbrëmjen e kaluam në Peshkopi dhe aty e kam njohur oficerin e ushtrisë Shqiptare, Agron Salillarin. Të nesërmen kam shkuar në Tiranë. Kam qëndruar gjashtë javë dhe e kam shetitur bukur mirë Shqipërinë. E kam vizituar Aziz Zhilivodën, (dajën e Gjyshit tim, nga dajtë e mi), dhe katër ditë kam bujtur në shtëpinë e tij në Elbasan, ku pata njohur edhe vajzën e vetme të tij, Mërgimen, e cila ishte martuar me një shqiptar nga Kosova. Shumë kemi biseduar me të, dhe vazhdimisht thoshte: "Mos vdeksha pa ardhur edhe një herë në Kosovë! Boll kam vrarë shkie, po kur i kam parë helmimet e nxënësve në ekran, i kam thënë Azizit (vetes pra), kurgja s'ke ba nëse nuk vret shkie prap". Më fliste me admirim për Bajram Zukën, Sylë Bilallin, Bajram e Ramadan Dobrën. "Do ta tregojë një

sekret, - më tha. Në një rast, pushkën me të cilën kam vrarë shkie, si në kallamboq, ja kam lënë Ramadan Dobrës. Ai më pati dhënë një pushkë të keqe, që do t`ja dorëzoja kur kam rënë në dorë të Kadri Hazbiut. Ndërsa Kadri Hazbiu më pati thënë, po e citoj: "Pa rënë koka ime, s`bie Aziz Zhilivoda".

Pushka automatike e Aziz Zhilivodës i ka shërbyer luftës së UÇK-së. Gjatë gjithë kohës në luftë e ka mbajtur nipi i dajës Ramadan, Hysen Dobra. Tani ajo pushkë është në Muzeun e Kosovës, ku janë edhe shumë eksponate të tjera të UÇK-së. E kam vizituar po ashtu edhe familjen e dëshmorit Jusuf Gërvalla, edhe shumë familje të tjera shqiptare. Ishin shumë mikpritës (!), ishte e pabesueshme; krejt çka kishin në shtëpi ta shtronin në sofër.

Siç thash në fillim, në Shqipëri, sipas porosisë së Komandantit Adem Jashari, e kam vizituar Përfaqësinë e Kosovës, ku kam takuar përfaqësuesit e saj, Dr. Ali Aliun dhe Zymer Berishën. As me Profesorin as me Zymerin nuk njiheshim më parë, ndaj me kujdes jam përpjekur t'i flas Zymerit për porosinë e Komandantit. Por meqë nuk njiheshim mirëfilli, ai nuk tregoi interesim për asgjë. Edhe unë nuk desha t`i imponohem. U ndamë dhe vazhdova me planet e mia. Po atë ditë, në Përfaqësinë e Kosovës takova edhe regjisorin e njohur të filmit z. Ekrem Kryeziun, i cili asokohe punonte për realizimin e një filmi. Pas gjashtë javësh jam kthyer në Kosovë sërish nëpër fshatin Klloboçicë.

Ndërsa herën e dytë në Shqipëri kam shkuar me Ramadan Gashin. Ishim për vizitë në Shkup: Babai, Axha Ismet, Dani dhe Unë. Kemi bujtur një natë në Shkup, dhe të nesërmen unë e Dani, nga Dibra, kaluam kufirin sërish në Klloboçicë. Kemi shëtitur gjithandej. Thonë se rasti është mbreti i botës. Një ditë i kemi takuar në zemër të Tiranës: Plakun-Shaban Jashari, bacin Rifat, dhëndrin e tyre, Ilmi Nuradinin dhe Zymer Berishën. Tanimë, Zymeri kishte ndryshuar, ishte më i hapur, të paktën ashtu dukej. Një mbrëmje kemi dalë bashkë të shetisim, dhe duke i shikuar disa çifteli, baci Rifat pati thënë: "Sa do ta dëshironte Hamza një këso çiftelije!" E kemi zgjedhur një bashkarisht, ja kemi dhënë Ilmi

Nuradinit, pastaj ai e ka çuar në Prekaz dhe ia ka dorëzuar Hamzës. Ajo është çiftelia me të cilën Hamza i këndonte Zhujë Selmanit. E vizituam edhe Muzeun Kombëtar në Krujë, bashkë me bacën Shaban e bacën Rifat Jashari.

Sheradin Berisha: *Bac, gjatë këtij bashkëbisedimi shpërfaqëm aktivitetin tuaj si anëtar i LDK-së, dhe në këtë kuadër kishit vizituar edhe Përfaqësinë e Kosovës në Tiranë. Pas formimit të Qeverisë së Kosovës në exil, në krye me Bujar Bukoshin, kjo përfaqësi konsiderohej si "qendër diplomatike" e Kosovës, dhe jo vetëm kaq. Në vitin 1992-1993, Qeveria e B.Bukoshit angazhoi disa ish-oficerë, për formimin e Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës, dhe ky organizim kishte filluar të strukturohet edhe në nivelet komunale. A kishte një organizim të tillë edhe në Skënderaj?*

Idriz Mehmeti: Ashtu është! Në vitin 1993, qeveria e Bukoshit pati nisur, kinse organizimin e Ministrisë së Mbrojtjes, për formimin e Ushtrisë së Kosovës, e cila do bënte përgatitjet për luftë në një të ardhme të afërt. Nismëtarët e këtij organizimi në nivelin komunal, dinin për autoritetin tim dhe të familjes sime, ndaj dhe kërkuan ndihmën time, të Bislim Bajramit e ndonjë aktivisti tjetër, që ishte me ndikim. Për këtë gjë kam njoftuar Adem Jasharin dhe kryetarin e LDK-së, Idriz Rrecin. Të dy më kanë sugjeruar që të jem i kujdesshëm, por të mos i shmangem përkrahjes që është kërkuar prej meje. Dhe për aq sa kanë qenë kapacitetet e mia, nuk jam kursyer, kam shpresuar se do të bëhej një kombinim i mirë i të gjithë atyre që dinë, duan dhe që janë të gatshëm t`i kundërvihen regjimit pushtues serb. Shpresoja se roli im do të jetë i nevojshëm në afrimin e veprimeve të të dy organizimeve, të cilat kishin të njëjtin qëllim, çlirimin e Kosovës. Për fat të keq, ky organizim i "ministrisë" së Bukoshit shumë shpejt u zbulua dhe kreu i saj do të prangosej, pa bërë asgjë konkrete. Ishte e paqartë për mua si u godit me të parën koka! Ndërkohë, shumë vetë u arrestuan, e shumë tjerë u arratisën në Shqipëri. Në vitin 1994 u morën vesh të gjitha marifetet e këtij organizimi.

Sheradin Berisha: *A u rrezikuat Ju nga kjo fushatë burgosjesh?*

Idriz Mehmeti: Po, edhe unë u rrezikova. Ishin bastisur veprimtarë të shumtë gjithandej nëpër Kosovë, disa ishin arrestuar e burgosur, disa kishin arritur t'i shmangen arrestimit. Milicia serbe shtëpisë sime ia mësyni në mëngjesin e hershëm të 3 nëntorit 1993. Në këtë ditë njëkohësisht rrethohen e bastisen shtëpitë e familjeve të Jakup e Adem Nurës në Prellovc, dhe familja ime në Krasmirovc. Qëllimi i kësaj ekspedite policore ishte arrestimi im, i Jakupit dhe Ademit, por meqë ne të tre nuk ishim në shtëpi, arrestuan Ismail Nurën (babain e Jakupit) dhe Ruzhdi e Sami Nurën (vëllezërit e Jakupit); Abedin Nurën, vëllai i Adem Nurës dhe Skender e Bekim Mehmetin, vëllezërit e mi. Të gjithë të arrestuarit i kanë dërguar në Skënderaj e më pas në Mitrovicë, dhe i kanë torturuar mizorisht. Pas kësaj ngjarjeje të rëndë, nga tre nëntor 1993, unë kalova në ilegalitet të thellë.

Sheradin Berisha: *Sa kohë qëndruat në ilegalitet?*

Idriz Mehmeti: Rreth tre muaj kam qëndruar në ilegalitet.

Sheradin Berisha: *... e pastaj?*

Idriz Mehmeti: Pastaj, meqë ishte e pamundur qëndrimi dhe angazhimi im i mëtejshëm brenda në Kosovë, vendosa të dalë jashtë.

Sheradin Berisha: *A u konsultuat paraprakisht me dikë për vendimin tuaj?*

Idriz Mehmeti: Po, fillimisht njoftova Komandant Adem Jasharin, për vendimin që kisha marrë. "Sa për duhan, për bukë e për strehë, mos shko" - më tha, - "ku rri unë ka vend edhe për ty!". "Jo" - i thashë, - "kam vendosur të dalë përkohësisht, nuk do rri shumë, të premtoj!...". "Mirë" - tha, - "le të bëhet si është më së miri!..."

Sheradin Berisha: *...dhe cilit vend të perëndimit ia mësytë?*

Idriz Mehmeti: Në gjysmën e dytë të Janarit të vitit 1994 u nisa për në Zvicër.

Sheradin Berisha: *Cili ishte rrugëtimi juaj për në Zvicër, kah shkuat*?

Idriz Mehmeti: Kam kaluar në Shqipëri, me djalin e dajës tim, Hamit Dobrën. Me të mbritur në Tiranë u paraqita në zyrën e Kosovës. Kisha nevojë për dokumenta personale, (sepse shërbehesha me pasaportën e dajës Hamit), dhe meqë do të udhëtoja nga porti i Durrësit, (me anije), mund të kisha probleme me organet kufitare. Në "përfaqësinë" e Kosovës shkova me shokun tim, Gani Veselin, i cili disa muaj më parë ishte arratisur, në Shqipëri. Na priti Skënder Zogaj, përfaqësuesi i zyrës. Më priti mirë, sidomos kur e kuptoi se qëllimi im ishte Europa. Pastaj kalova nga Durrësi në Itali, dhe përfundova në Bern të Zvicrës. Atje e kisha vëllain tim, Halilin. Kam bërë kërkesën për azil (strehim politik) në Bazel, dhe më pastaj, me kërkesën e vëllait tim, Halilit, u transferova në Bern.

Sheradin Berisha: Bac, fatin e njëjtë, të largimit nga Kosova e përjetuan shumë veprimtarë! Dikush shkoi në Zvicër, dikush në Gjermani, në Austri, Francë, Suedi, e në vende të tjera. Ato ditë, cili ishte aktiviteti juaj primarë në Zvicër?

Idriz Mehmeti: Ashtu është, veprimtarët u shpërndanë në gjithë Evropën! Pasi jam stabilizuar pak, menjëherë jam interesuar për shumicën e veprimtarëve që kishin kaluar në shtetet perëndimore dhe veçanërisht për ata që kishin mbetur në Shqipëri. Të gjithë shokët, që përkohësisht ishin strehuar në Shqipëri, ishin në gjendje të rëndë materiale. Thjeshtë, kishin mbetur pa kurfarë përkujdesje. Ushqimi i vetëm ditor ishte: bukë e qepë! Për më keq, ka pas raste që ndonjëri prej tyre ta kalonte edhe natën nën qiellin e hapur, në parkun e Tiranës. E dhimbëshme, por e vërtetë (për këtë kam fakte).

Sheradin Berisha: *Në këtë odiseadë largimesh nga Kosova, cilët shokë (të pushkës) të Adem Jasharit dolën jashtë Kosovës?*

Idriz Mehmeti: Thënë të vërtetën, grupi i Drenicës, me në krye Adem Jasharin, gjatë kësaj kohe, (1993-1994), ishte reduktuar në masë të madhe. Jashtë Kosovës kishin dalur: Ilaz Kodra, Sami Lushtaku, Jakup e Adem Nura, Rafet Rama, Ramiz Lladrovci, Fatmir Istogu etj. Po ashtu, nga Kosova janë larguar edhe disa veprimtarë tjerë të Lëvizjes Popullore të Kosovës, të cilët më herët mbanin kontakte me Komandant Ademin, si: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Mehmet Bislimi, Ilmi Zeka e disa të tjerë. Edhe Fehmi Lladrovci bashkë me Xhevën nga Kroacia kishin kaluar në Gjermani…

Sheradin Berisha: *Në këtë kohë krize, me cilët shokë kishte mbetur Adem Jashari në Drenicë, a e shtoi numrin e bashkëluftëtarëve dhe zonën e veprimit?*

Idriz Mehmeti: Adem Jashari, nuk u zvogëlua kurrë, as s'u ligështua kurrë! Ai në këtë periudhë e shtoi numrin e bashkëluftëtarëve, si dhe e zgjeroi zonën e veprimit në Dukagjin e Llap. Tashmë, në njësitë e tij komanduese ishin: Sylejman Selimi (Sulltani), Rexhep Selimi (Dhjetëshi), Xheladin Gashi (Plaku), Nait Hasani, Bislim Zogaj, Adrian Krasniqi, Mehë Uka, Luan, Shkëlzen e Daut Haradinaj, Zahir Pajaziti, Hakif Zenullahu e Edmond Hoxha (Edi), Mujë Krasniqi (Kapuçi) bashkë me bilbilin e këngës Beqë Mleqanin, Rasim Kiçina (Tajsoni), Sabit Lladrovci (Jasha), Jahir Demaku dhe vëllezërit e tij, Ilaz Dërguti, vëllezërit: Vesel (i njohur me pseudonimin Rambo) e Sami Oruçi, (më vonë mobilizohet edhe vëllai i tyre Seferi, dhe që të tre provuan plumbat e serbit në gjoks), Beqir Meha, Osman e Jetullah Geci (dajtë e Ademit), si dhe kushërinjtë e tyre Sabit Geci me vëllezërit e tij, Xhevahir Geci, Xhemë Kodra, Shekip Fazliu, (Shekipi është personi i fundit që u nda nga familja Jashari, dhe njëkohësisht tërhoqi shëndoshë e mirë edhe Bashkim Jasharin, djalin e bacit Rifë, në epopenë e lavdishme të 5-7 marsit 1998), Rrahman Rama, Jahir Hajdari, e shumë e shumë të tjerë. Komandant Adem Jashari, me këta bashkëluftëtarë dhe shumë të tjerë, që do t'i bashkohën gjatë viteve 1994 - mars 1998, do të kryej dhjetra aksione të armatosur në mënyrë të sinkronizuar, mbi forcat policore e

bashkëpunëtorët e UDB-së. Dhe armiku do të detyrohet t`i ndërpresë tërësisht lëvizjet e veta gjatë natës, në zona të caktuara.

Sheradin Berisha: *Kjo ka bërë që Adem Jashari të bëjë kthesën e madhe historike në luftën për çlirim nga Serbia. A mbanit kontakte me Adem Jasharin gjatë qëndrimit në Zvicër?*

Idriz Mehmeti: Po, diku nga viti `95, u informova nga dhëndrri i tij, Ilmi Nuradini, se komandanti Adem Jashari ishte pajisur me një telefon. Shumë shpejtë, numrin e tij ma ka përcjellë baci Rifat. Pastaj vazhdimisht kam kontaktuar me të, dhe kam qenë i informuar sikur të isha në Kosovë. Ndërsa për çështje më delikate, që s`duhej të fliten në telefon, lidhja e vetme me Ademin ishte vëllai im, Halili, i cili kishte kontakte të rregullta direkte me Komandantin…

Sheradin Berisha: *Ju me kërkesën e vëllait u vendosët në Bern, kur t'u njoftë strehimi politik, për të lëvizuar lirshëm nëpër Zvicër?*

Idriz Mehmeti: Po, pas katër muajve më është njohur statusi i refugjatit politik në Zvicër. Kështu që m'u krijua mundësia e lëvizjes… Kam marrë kontakt gati me të gjithë ata miq e shokë me të cilët na lidhte e kaluara.

Sheradin Berisha: *Cili ishte aktiviteti juaj, nga momenti kur morët statusin e refugjatit politik në Zvicër?*

Idriz Mehmeti: Gjatë viteve 1994 - mars 1998 kam kryer shumë aktivitete. Nga vjeshta e vitit 1994 deri në fund të majit 1998 isha kryetar i shoqatës "Drenica" në Zvicër. Dy vite, (1985/86) isha edhe kryetar i Klubit "Hasan Prishtina" në Bern. Pastaj nga vjeshta e vitit 1995 e deri më 5 Mars 1998 isha edhe anëtar i LDK-së, dega në Zvicër. Me 5 mars 1998, kur u sulmua Komandant Adem Jashari dhe familja e tij në Prekaz, me shkrim pata dhënë dorëheqje nga LDK-ja. I shkrova gjithashtu edhe një letër Kryeministrit në ekzil, Bujar Bukoshit.

Sheradin Berisha: *Bac, gjatë kësaj periudhe, duke qenë në krye të Shoqatës "Drenica", Klubit "Hasan Prishtina" dhe mbi të gjitha, veprimtar i LDK-së, dega në Zvicër, sigurisht keni patur aktivitete të shumta dhe bashkëpunim të gjerë, jo vetëm me bashkëvendasit tuaj nga Drenica, por edhe me shokët e burgut, siç ishin: Jashar Alia, Gani Sylaj, Xhafer Shatri etj. Madje ky i fundit ishte edhe ministër për informata në qeverinë e Bujar Bukoshit. A kishit vënë kontakte bashkëpunimi me ministrin Shatri, nëse po, cili ishte niveli i bashkëpunimit…?*

Idriz Mehmeti: Po, në këtë kohë unë kisha krijuar një bashkëpunim të gjerë me të gjithë veprimtarët, pavarësisht ku ishin të organizuar. Personalisht isha i bindur që moti, se lufta ishte e pashmangshme. Ndaj s`kam lënë gur pa lëvizur, që atë pak ndikim që kisha ta vendosja në shërbim të luftës. Qysh në fillim kur pata ardhur në Zvicër, kisha marrë kontakt pikërisht me Xhafer Shatrin, ish "Ministër për Informata" në "Qeverinë e Ekzilit" të Bujar Bukoshit. Tek Xhaferi kisha besimin dhe shpresën, se do t`i shërbente me shumë përkushtim çështjes në fjalë. Ai prej se ishte i ri kishte dhënë prova. Personalisht kisha një simpati të jashtëzakonshme për të. Madje mund të them se në kohën sa kam qenë në burg, jam ushqyer me qëndrimin e tij. Sidomos, kur në burgun e Kotorrit të Malit të Zi pata mësuar për qendresën e tij e të Isë Kastratit, vlerësimi dhe respekti për të m`u shtua edhe më shumë. Urrejtja raciste e gardianëve të burgut në Kotorr për këto dy figura të kombit, ishte edhe një dëshmi shtesë e karakterit të tyre... Xhaferi ishte shumë i interesuar të dinte sa dhe si ishin të organizuar grupet e armatosura në Kosovë. I kam thënë Xhaferit se, Ademi me shokë nuk e ka për mahi, e ka seriozisht luftën për çlirim nga regjimi pushtues serbë. I kam thënë, ata flejnë me pushkë nën kokë, që nga fundi i dhjetorit 91... I kam thënë se Grupi i Ademit, ngadalë, por sigurt, çdo ditë po shkon duke u rritur dhe se ata kanë shumë nevojë për mjete e teknikë të luftës. Kështu, meqë ai interesohej aq shumë, e kam pyetur, nëse kishte shpresë që të ndikonte te Bukoshi që ata djem t`i mbështesnim me armatim! Përgjigjia e tij ka qenë e shkurtë dhe e qartë: "Po! Posi, - më thotë - ndryshe nuk kam pse të rri në një qeveri, e cila nuk do ta mbështeste luftën për çlirim".

Më duhet të theksoj, se Adem Jashari vazhdimisht ka kërkuar teknikë luftarake. Ai kurrë s`kërkonte të holla; po e ripërsëris, Ademi kërkonte me këmbëngulje vetëm teknikë luftarake. Për këtë çështje shumë herë i ka dhënë vërejtjet e tij plotësisht të arsyeshme. Aspak nuk ishte i kënaqur me furnizimet që bëheshin nga përsonat e autorizuar për furnizim. Fondi "Vendlindja Thërret", realisht, mundësitë i kishte shumë më të vogla, krahasuar me Qeverin e Bukoshit. Bazuar në nevojat që kishte Adem Jashari dhe njësitet e tjera në Kosovë, ndihmat e dhëna nuk ishin në nivelin e duhur, ndërkohë që premtimet ishin krejtësisht tjera. Prandaj, ata që ishin obliguar dhe kishin premtuar, duhej të ishin shumë më të përgjegjshëm. Ata duhej ta dinin se po hynim në luftë, dhe lufta kërkonte më shumë veprime konkrete, se fjalë.

Sheradin Berisha: *Bac, me këtë përgjigje hapët shumë tema me rëndësi, të cilat kërkojnë një shtjellim më përmbajtësorë! Dihet mirëfilli, se nga viti 1992 - 1994 në Perëndim vepronin paralelisht dy fonde: Fondi i Qeverisë së Bujar Bukoshit (që quhej fondi i 3%-it), dhe fondi "Vendlindja Thërret", të cilin e kishte hapur Lëvizja Popullore e Kosovës, Dega jashtë vendit, për ta financuar UÇK-në.*

Fondi i 3%-it shërbente për mbajtjen e institucioneve fiktive në Kosovën e pushtuar nga Serbia, ndërsa kishte fjalë të mëdha nga kryeminstri i këtij fondi, Bujar Bukoshi, se do ta ndihmonte edhe luftën e armatosur, kur t'i vinte koha! Ndërkohë Fondi "Vendlindja Thërret" edhe pse mundësitë financiare i kishte shumë më të vogla, megjithatë kishte aq mjete sa për t'i furnizuar njësitë guerile në Kosovë (gjatë viteve 1995 - mars 1998) me armatim të lehtë dhe armë kundër mjeteve të blinduar, tankeve dhe autoblindave. Nuk e di si kanë vajtur punët në fondin e 3%-it, por e di mirëfilli se si kanë vajtur punët në Fondin "Vendlindja Thërret", ku isha edhe unë i organizuar. Në kuadër të LPK-së, vepronte Sektori i Veçantë, për armatimin e njësiteve të UÇK-së në Kosovë. Përgjegjës i këtij sektori ishte Xhavit Haliti - Zeka, ndërsa anëtarë ishin: Azem Syla dhe Ali Ahmeti (sa më kujtohet). Kjo treshe e kishte për detyrë t'i furnizonte njësitet e UÇK-së në Drenicë në krye me Adem Jasharin, në Llap në krye me Zahir Pajazitin, në Dukagjin në krye me

Lahi Brahimajn e Luan Haradinajn etj. Por, fatkeqësisht ky Sektor, gjegjësisht Xhavit Haliti dhe Azem Syla, nuk e kanë kryer këtë obligim në masën e duhur, veçanërisht ndaj njësitit të Adem Jasharit në Drenicë! Ata e kanë sabotuar Adem Jasharin! Dhe meqë ishte një situata e tillë, Adem Jashari, sikundër thoni dhe Ju, "vazhdimisht ka kërkuar teknikë luftarake" dhe "s'kërkonte të holla"! E di mirëfilli, se në vitin 1995 Fehmi Lladrovci, në cilësinë e anëtarit të kryesisë së Nëndegës së LPK-së për Gjermani, e veçanërisht nga shkurti i vitit 1996, kur ai u zgjodh kryetar i kësaj Nëndege, ka kërkuar zëshëm që paratë e anëtarësisë së LPK-së dhe ato të fondit "Vendlindja Thërret" të materializohen në armatim, dhe t'i dërgohen Adem Jasharit dhe formacioneve të tjera që operonin në Kosovë! Dhe kjo ka ndodhur, por megjithatë nuk mjaftonin ato mjete për rritjen, zgjerimin dhe forcimin e luftës së armatosur!

Meqë kjo situatë e rëndë (mungesa e armatimit) e ka përcjellur tërë kohën komandantin Adem Jashari, në dhjetor të vitit 1997 Ademi, bashkë me Hamëz Jasharin e shkruajnë një letër drejtuar shokëve jashtë vendit! Kjo letër është publikuar për herë të parë në portalin pashtriku.org (në mars 2008), ndërsa origjinali gjindet në arkivin e LPK-së. Adem Jashari në letër shkruan: "Kemi kërkesa të mëdha për antarësim, por mungon armatimi. Shumë pak keni punuar në këtë drejtim. Prandaj shokët që veprojnë në këtë trevë të Drenicës, kërkojnë që të përfaqsohemi me nji nga shokët tonë të mëhershëm, që tani e disa kohë gjendet jashtë, nën emrin e tij konspirativ "VESHI"." - Veshi ishte pseudonimi i Ramiz Lladrovcit. (Më gjerësisht letra mund të lexohet këtu : http://pashtriku. beepworld. de/files/AdemJashari/letraeademjasharit_dhjetor_1997_08.3.08.htm)

Pra, sipas letrës, Adem Jashari ka treguar se ka kërkesa të mëdha për anëtarësim në radhët e UÇK-së, "por mungon armatimi", dhe "shokëve" ju tregon hapur se, "shumë pak keni punuar në këtë drejtim", dhe pastaj, në emër të bashkëluftëtarëve të tij, kërkon që të përfaqësohen jashtë nga shoku i mëhershëm, "veshi" - Ramiz Lladrovci.

Pikërisht në janar të vitit 1998 Rifat Jasharit (vëllait të Ademit) në Mynhen të Gjermanisë, një veprimtar i ofon një shumë të konsiderueshme të parave, (diku 40 mijë e ca Dm., nëse nuk gaboj), për t'i blerë të gjitha llojet e armatimit për Adem Jasharin.

Një vit më herët, Baci Rifat, saktësisht më 1 shkurt 1997 i kishte pranuar edhe 5830 Dm., nga grupi i shokëve të Adem Jasharit, me të cilët ka qenë në stërvitje ushtarake në Shqipëri, (në vitin 1991). Paratë i dorëzojnë: Osman Ferizi dhe Ramadan Begu, ndërsa i pranon Rifat Jashari.

Shikoni Faksimilin e dëshmisë: 5830 Dm.

NDIHME FINANCIARE PER SHOKET NE KOSOVE.

1. MUHARREM	BOBAJ	1000 DM
2. RAMADAN	BEGU	300 "
3. EKREM	SHEHOLLI	300 "
4. SAIM	TAHIRAJ	300 SFr
5. ILMI	PEÇI	300 DM.
6. LUTFI	JONUZI	300 "
7. IMER	ALIU	300 "
8. HASAN	FERIZAJ	300 "
9. DEME	TOLAJ	250 SFr
10. ISMET	TAHIRAJ	250 " (NE EMER TË SHISH NEUCHÂTEL)
11. SHERIF	TOLAJ	250 "
12. OSMAN	FERIZI	300 DM.
13. FADIL	TOLAJ	200 SFr
14. ALI	BERISHA	110 DM
15. BEQIR	KAMERAJ	100 SFr
16. FADIL	LEKAJ	100 DM
17. SHEMSI	HAZIRI	100 "
18. SALI	ÇEKU	100 "
19. LEON	HYSENAJ	100 "
20. KADRI	GUBETINI	100 "
21. ISMET	LAJQI	100 "
22. UJKAN	ZENELI	100 "
23. RUZHDI	BAJRAMI	100 "
24. ALUSH	FERATAJ	100 "
25. SKENDER	TOLAJ	100 SFr
26. ESAT	LATAJ	50 SFr.

SHUMA E PËRGJITHSHME: 5830-DM.

TË HOLLAT I DORZUAN:

1. OSMAN FERIZI-
2. RAMADAN BEGU-

I PRANOI:

1. RIFAT JASHARAJ-

Münich 01.02.'97.

Baci Rifat, për këto çështje flet hapur në emsionin "Pa rrotlla" (2013!

Në pyetjen e gazetarit Milaim Zeka: "Mbasi u morë vesh jashtë, se Ademi me grupin e vetë nuk po e lëshon Kosovën, dhe po qëndron këtu… Me sa di unë ka pas njerëz të interesum që kanë ardhë te ti, kanë ofru pare për ndihmë për armë, e për të gjitha këto?"

Baci Rifat, përgjigjet: "Këtu është Milaim vetëm grupi i shokëve të Adem Jasharit, me të cilët kanë qenë në stërvitje bashkë, diku 5800 Dm, tjera nuk ka pas…"

Milaim Zeka: "Një person që ka ardh ka sjell një shumë të parave, e që i kanë sjell Luli (Lulzimi - djali Ademit) dhe Ramizi (Lladrovci) në Tiranë për armë."

Baci Rifat, thotë: "Ato, unë sot për bes të zotit s'e njoh atë individ. Ai i ka pru ato, kanë shku këta (Luli dhe Ramizi). Armët janë ble, ardh nuk janë. Këto mund t'i dinë Azem Syla, Rexhep Selimi e shumë shokë tjerë që janë kanë... Ti e din fortë mirë, qi je kanë me Azemin aty, kemi ba një bisedë në dhomë teme (në Mynhen), ai thotë ja kam çu Rexhepit, Rexhepi thotë diçka tjetër, por ma në fund ato (armët) nuk kanë arritun! Ku janë met, ka janë shku… Ma nuk jam marrë me atë punë, e pash se nuk ja vlen…"!

Lidhur me takimin e Rifat Jasharit me Azem Sylën në Mynhen (pas rënies së Adem Jasharit me tërë familjen, më 5 -7 mars 1998), Milaim Zeka në emisionin "Komiteti", (dhjetor 2016), thotë se kam qenë i ftuar nga Baci Rifat, dhe aty ai kërkon llogari nga Azemi për ato pare që i kanë marrë në Tiranë, bashkë me Shaip Mujën, për t'i blerë armët, dhe nuk i kanë dërguar. Azemi thotë se ia kemi dërguar Rexhep Selimit, ndërsa Rexhep Selimi e mohon një gjë të tillë. Dhe në fund del, se Azem Syla nuk i ka dërguar armët, dhe paratë i kanë shpenzuar për gjëra tjera. Milaimi tregon, se me këtë rast, Baci Rifat i thotë Azem Sylës: "Millosheviçi ma ka borxh vrasjen e familjes, ndërsa gjysën e borxhit ma keni ju"!

Milaimi për këtë temë flet nga minuta 16:30 - 19:50. Shikoni: Emisioni "Komiteti Qendror" - Mysafir, Milaim Zeka: https://www.youtube.com/watch?v=_XX4AQQ2TUU

***

Bacë, i thashë të gjitha këto, për të kuptuar lexuesi mirëfilli, sabotimin dhe mungesën e armatimit për Adem Jasharin dhe pengesat që kanë ndodhur në këtë drejtim!

Tani të kthehemi te premtimi i Xhafer Shatrit. Më lartë theksuat, se Xhafer Shatri, në cilësinë e ministrit të qeverisë Bukoshi, para teje zotohet se," nuk do të rrija në një qeveri e cila nuk do ta mbështeste luftën për çlirim". A e mbajti premtimin e dhënë Xhafer Shatri, apo edhe ai me B.Bukoshin e sabotuan, Adem Jasharin?

Idriz Mehmeti: Para se të përgjigjem në këtë pyetje fillimisht dua t'ju tregoj një ngjarje tjetër, që lidhet me Xhafer Shatrin.

Sheradin Berisha: *Për çfarë ngjarje bëhet fjalë?*

Idriz Mehmeti: Në Janar 1998 Xhafer Shatri kërkoi nga unë që ta dërgonim një gazetar të "New York Times-it" (amerikanin Chris Hedges) në Prekaz, që t`i kontaktonte ushtarët e UÇK-së, për të cilin thoshte se është më shumë se gazetar. Po, çfarë na ofron ky gazetar nëse ia mundësojmë takimin me Adem Jasharin! - e pyeta Xhaferin! Do ta botojë një artikull në "New York Times", tha, por të thashë që ai nuk është vetëm gazetar. Unë, meqë komunikoja drejtpërdrejtë me Komandantin, e pyeta në telefon: e kam një farë miku nga Amerika, dëshiron të ta bëjë një vizitë, çka ta merr mendja ty?! "Le të vijë!", tha. Mos po na nxjerrë telashe, i thashë!.. "A ka 'brirë?", më pyeti Komandanti. Jo, thashë, brirë s`ka po i ndihet zëri larg! "Le të vijë, tha, me dëshirë do ta pres!" Paraprakisht e dija përgjigjen, por rendi e donte ta pyesja.

Sheradin Berisha: *Dhe si vajti kjo punë ?!*

Idriz Mehmeti: Nuk u mjaftova me kaq! Kam shkuar në Gjermani te Baci Rifat Jashari me disa nga shokët që aso kohe bashkëvepronim, me Gani Sylën, Jashar Alinë, Naser Tupellën dhe Nusret Krasniqin! I kam shpjeguar kërkesën e Xhaferit Shatrit, dhe po ashtu edhe për përgjigjen e Komandantit, "por ndjeva nevojë të marr edhe mendimin tend", i thashë

bacit. Baca Rifat na tha: "Për vizitën shumë ua di për nder, ndërsa për amerikanin, ju nuk duhet të më pyesni fare, nëse vetëm pak i hyn në punë Kosovës, patjetër duhet ta bëni!" Po mundet të na sjellë telashe, i thashë. Ai nuk është dosido gazetar! "Punë e madhe!, tha. A i hyn në punë Kosovës?! Gurë mbi gurë mos mbettë!"

Me t`u kthyer nga Gjermania e kam njoftuar Xhaferin. Ai m`i ka dhënë informatat se ku dhe kur mund ta gjej gazetarin në Prishtinë, në çfarë lokali dhe në çfarë kohe. Kishim lënë dy termine, nëse i pari do të dështonte, i dyti jo. Pas përcaktimit të planit, të nesërmen amerikani do të fluturonte nga Cyrihu për Prishtinë, unë për Tiranë, ku do të vinte Gani Koci të takohej me mua dhe do ta merrte planin. Dhe të nesërmen do ta gjente amerikanin në vendin e caktuar dhe do ta dërgonte në Prekaz. Do ta priste Komandanti me një togë ushtarësh, ndërsa bisedën me të do ta zhvillonte Hamza. Kështu si u tha, pa pikë pa presje u bë. E kisha edhe planin rezervë po qese Ganiut do të mund t`i dilnin pengesa, ngaqë ai nuk ishte i panjohur për policinë serbe. Plani rezervë ishte Arbëresha e Gani Bunjakut, që aktualisht studjonte në Tiranë. Arbëresha, në rast të dështimit të planit të parë, do të shkonte në Prishtinë, do ta gjente siç ia kisha prezentuar personin, në vendin e caktuar, dhe do ta pyeste: "A jeni ju udhëtari?" Kështu ishte parulla. Dhe do ta merrte me makinë e do ta dërgonte në Prekaz. Asaj, si mbesë e Shaban Bunjakut, një kushëri i yni, dhe ish luftëtar i Mehmet Gradicës, i rënë heroikisht në luftën e 1945-ës, qerpiku nuk i dridhej; u zotua se pa pikë frike dhe me plotë dëshirë do ta kryente këtë detyrë. Mirëpo, për fat, nuk pati nevojë, punën e bëri Gani Koci shumë mirë. Me t`u kthyer, amerikani bëri një artikull të gjatë e të fortë në favor të UÇK-së, në gazetën "New York Times". Kujtoj, se ishte artikulli i parë pozitiv i një gazete të huaj e prestigjoze!

***

E tani t'i përgjigjem pyetjes tjetër që më bëtë, lidhur me premtimin e Xhaferit, për ta ndihmuar me armë Adem Jasharin!

Sheradin, qëndrimet e njohura të Bukoshit dhe shpresa se Xhaferi do të ndikojë pozitivisht tek ai, fillimisht më dha të drejtë të mendoj, se e gjeta aleatin e vërtetë, që Ademit dhe shokëve të tij do t'u krijonim kushte të favorshme për luftë. Kam pasur shumë takime me Xhaferin, shumë biseda, dhe gjithmonë shpresoja. Mirëpo, shpresa ime mbeti vetëm shpresë.

Sheradin Berisha: *Pse mbeti vetëm shpresë, a kishit ndonjë nismë për blerjen e armatimit për Adem Jasharin, dhe Qeveria e Bukoshit nuk e mbajti fjalën, apo... ku ishte problemi?*

Idriz Mehmeti: Po, pikërisht kishte të bënte me blerjen e armatimit për Adem Jasharin. Adem Jashari në fillim të shkurtit 1998 kishte siguruar një sasi të konsiderueshëm armatimi përmes lidhjeve që kishte. Bëhej fjalë për 1000 armë të llojeve të ndryshme, me 1000 çanta municione, po ashtu edhe transporti. I kërkova Xhafer Shatrit të realizohet kjo punë! Pasi të shkarkohej malli në Prekaz, ne do të paguanim mallin në Tiranë (çmimi ishte 620.000 DM.) Kjo ishte shansa e fundit e "Qeverisë së Egzilit" (Rezilit), kështu siç e përshkrova. Fillimisht Xhaferi më tha: "Po, shpejt do ta realizojmë!" U caktua termini dhe të vinte Baci Rifë, t`i merrnim të hollat, dhe pastaj unë bashkë me bacin të shkonim në Tiranë; të nisnim kontigjentin për në Prekaz, dhe sipas marrëveshjes, e thashë edhe më herët, pasi të shkarkohej "malli" në Drenicë, me urdhër të Komandantit, në Tiranë do të bënim pagesën prej 620.000 DM. Baci Rifat erdhi tek unë në Bern të Zvicrës, bujti dy netë, dhe ditën e tretë u takuam me Xhafer Shatrin. Përgjigjja ishte negative!!! "Nuk guxojmë. Rrezikojmë fondin, - na tha Xhaferi, - por do të gjejmë një mundësi tjetër, do t`ia bëjmë disi! Fundja, do futemi disa shokë në kredi dhe do ta realizojmë kërkesën e djemve." U ndamë të zhgënjyer, baci Rifë dhe unë. Pastaj Bacin, bashkë me Ilir Tahirin e kemi përcjellë te stacioni i trenit. Shkoi shumë i zhgënjyer në Gjermani. Kurrë nuk e mora vesh cili nuk deshi që kjo kërkesë të realizohej, Bukoshi, Xhaferi apo të dy bashkë?!

Sheradin Berisha: *Dëm i madh për luftën tonë çlirimtare! Adem Jashari më bashkëluftëtarët e tij nuk e ka merituar sabotimin! Megjithatë ngjarjet rrodhën rrufeshëm në fundvitin 1997/98. Dalja publikisht e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 28 Nëntor 1997 në Llaushë të Drenicës, (me rastin e varrimit të mësuesit Halit Geci), ka bërë kthesë historike në vetëdijësimin e popullit shqiptar, në kuptimin se UÇK-ja ekziston dhe si e tillë nuk ishte "krijesë e shërbimeve sekrete serbe", sikundër e kishte cilësuar shpeshherë kreu i LDK-së në Prishtinë. Pas daljes publike të UÇK-së, kryekrimineli Millosheviç intensifikoi operacionet policore - ushtarake kundër UÇK-së dhe popullatës shqiptare. Më 22 janar 1998 forcat kriminale serbe sulmuan, (për herë të dytë pas 30 dhjetorit 1991), familjen e Shaban Jasharit në Prekaz. Të kujtohet kjo ngjarje?*

Idriz Mehmeti: Po me kujtohet shumë mirë kjo ngjarje. Më 22 Janar (1998) kam folur personalisht me bacën Shaban Jashari në telefon. Pa fije përtese më njoftonte se kanë kaluar mirë, janë plagosur lehtë dy vajza, mbesat, - më tha. Më kujtohet, në fund të bisedës më tha: "kësaj radhe, iu dhamë një mësim të mirë shkieve të shkinave"!

Sheradin Berisha: *Bac, ato ditë kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës, (janar - mars 1998), po bëhej gjithnjë e më shumë mbizotruese e situatës në Kosovë, u vu në lëvizje diplomacia ndërkombëtare, për të parandaluar rrjedhën e ngjarjeve që çonin pashmangshëm drejt një lufte të përgjakshme. Qasja e bashkësisë ndërkombëtare ndaj zgjidhjes së çështjes së Kosovës ndërtohej mbi qëndrimin e njohur siç ishte "mospranimi i gjendjes status quo" dhe "kundërshtimi i aspiratave të shqiptarëve për pavarësi". Mbi këtë bazë, gjatë vitit 1998, Grupi i Kontaktit dhe qendrat e tjera ndërkombëtare vendimmarrëse, përmes diplomacisë së ashtuquajtur lëvizëse, do të ngarendin sa në Beograd e sa në Prishtinë, për të gjetur një zgjidhje politike për Kosovën, përmes negociatave. Ngjarjet më kulmore që i dhanë kahje zhvillimeve politike në Kosovë, konsiderohen vizitat e shpeshta të ambasadorit amerikan Robert Geldbard, i deleguari special i SHBA-ve për ish-Jugosllavinë, në janar - mars të vitit 1998, në Prishtinë dhe në Beograd. Ambasadori*

Robert Geldbard në një nga takimet e tij, (më 22. 02. 1998), me kryetarin e LDK-së në Prishtinë, publikisht e akuzoi UÇK-në si: "organizatë terroriste"!

Me këtë veprim z.Geldbard haptazi kërkonte forcimin e lidershipit politik në krye me Ibrahim Rugovën. Një ditë më vonë z.Geldbard, gjatë një takimi me Millosheviçin, i dhuroi Beogradit lehtësira, duke deklaruar se disa nga sanksionet ekonomike që ia kishin vënë Serbisë do të hiqen! Ky veprim i diplomatit amerikan, skajshmërisht akuzues për UÇK-në, në të vërtetë i dha forcë shtytëse në aspektin politik kreut të LDK-së, ndërsa në aspektin ushtarak e trimëroi satrapin Sllobodan Millosheviç, për të marrë një ofensivë për zhbërjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për vrasjen e shqiptarëve dhe shkatërrimin e vendbanimeve të tyre. Dhe, në të vërtet, kjo nbdodhi! Më 28 shkurt 1998 forcat ushtarako-policore të Millosheviçit, në "emër të spastrimit të terenit nga bandat terroriste të UÇK-së", sulmuan fshatrat Qirez dhe Likoshan, me ç´rast vranë e masakruan 24 shqiptarë, gra, fëmijë e pleq të pafajshëm në shtëpitë e tyre. Të kujtohet ngjarja e Qirezit dhe Likoshanit?

Idriz Mehmeti: Po më kujtohet shumë! Në mbrëmjen e 28 shkurtit 1998 u informova për këtë ngjarje. UÇK-ja kishte zhvilluar një luftë të ashpër tek "gjashtë Lisat“ dhe me sukses kishte asgjësuar njërin nga dy grupet e milicisë serbe, që kishin ngritur pritën për t`i kapur djemtë e luftës. Edhe ushtarët tanë nuk ishin pa dëme, por ato të armikut ishin shumë herë më të mëdha. Tani falangat serbe, në shenjë hakmarrjeje do të vërsulen mbi popullatën duarthatë të kësaj ane. Epilogu dihet, u vranë shumë civilë të pafajshëm të këtyre fshatrave.

Sheradin Berisha: *Bac, një javë më vonë, më 5, 6 e 7 mars 1998, forcat barbare serbe sulmuan fshatin Prekaz, (tani për herë të tretë), duke përdorur gjithë arsenalin ushtarak modern kundër familjes së Shaban Jasharit. Pas një lufte 3 ditore (të pabarabartë), çetnikët e Beogradit vranë mizorisht 56 anëtarë të familjes Jashari, në mesin e të cilëve ra për të mos vdekur kurrë edhe komandanti legjendar i UÇK-së Adem Jashari. Kryekrimineli Millosheviç dhe disa qarqe ndërkombëtare*

gjykuan se me vrasjen e Adem Jasharit kanë shuar edhe UÇK-në, por ngjarjet që pasuan më vonë dëshmuan të kundërtën. Pas këtyre ngjarjeve ndërhyri diplomacia ndërkombëtare, e cila kërkoi ndërprerjen e dhunës së armatosur, për t'i lënë rrugë zgjidhjes së problemeve përmes dialogut midis palëve. Më 9 mars 1998 në Londër mbahet mbledhja e Grupit të Kontaktit, ku do të diskutohej për gjendjen e rëndë në Kosovë. Në deklaratën e Grupit të Kontaktit, kritikohet "përdorimi i tepruar i forcës" dhe "tejkalimi i autorizimeve" të njësive speciale të policisë serbe, "që ka sjellë për pasojë së paku 80 humbje jete", ndërsa denohen në tërësi, siç theksohet në deklaratë, "aksionet terroriste të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të çfarëdo grupi apo personi." Pra, Grupi i Kontaktit, operacionet shfarosëse të njësive speciale serbe kundër shqiptarëve i cilësonte si përdorim i tepruar i forcës, ndërsa veprimet e UÇK-së, që ishin në mbrojte të popullatës shqiptare nga forcat serbe, i cilësonte si "aksione terroriste"! Prandaj, me këtë rast, për vrasjen dhe masakrimin e familjeve shqiptare në Likoshan, Qirez dhe në Prekaz, personalisht i bëj përgjegjës edhe shtetet e Grupit të Kontaktit në krye me SHBA-të.

Idriz Mehmeti: Keni të drejtë! Nuk më kujtohet saktësisht, por duhet të ketë qenë dita midis 2 e 4 marsit, kur kam folur në telefon për herë të fundit me Hamëz Jasharin. Pastaj erdhi 5 Marsi! Në këtë ditë kisha mysafir Gani Sylën me disa shokë tjerë. Herët në mëngjes, në telefon e ka thirrur Ganiun, Hydajet Hyseni, dhe i foli shumë shkurt. "Prekazi është rrethuar, lufta po fillon!" - kaq tha Hydajeti.

Sa zbardhi drita mirë kemi shkuar në zyrën e LDK-së, në Bern. Çfarë mund të bënim nga Berni, çfarë, çfarë, çfarë! Asnjëherë në jetën time nuk më është dukur vetja më i padobishëm se atë mengjes 5 marsi! Sa kalonte koha, zyra vinte e mbushej me njerëz, por s'kishte asnjë dobi.

Filluan të qarkullonin informata e dezinformata nga më të ndryshmet. Vazhdimisht përpiqeshim të mësonim diçka, por ishte e pamundur, sepse thuajse ishte paralizuar gjithçka. Telefonatat nuk bënin punë. Pas tre katër ditësh thirra Gani Kocin. Qante si fëmijë, filloi t`i numërojë të

rënët: Baci Shaban, Hamza, Ademi, Fitimi, Kushtrimi... I kam thënë mjaft, mjaft, mjaft! Kam filluar të qaj me zë, si fëmijë. Mbaj mend që kam qenë me Gani Sylën, Shaip Bilallin, Ismet Rashitin dhe disa nga shokët, nuk më kujtohen tash të tjerët, dhe u kërkoj ndjesë. Nën dhimbjet e atij tmerri të paparë shpirtëror për ngjarjet me përgjakje mitike në Prekaz, një mbrëmje cingërroi telefoni. E kapa telefonin. Ishte Baci Rifat nga Gjermania! O zot, çfarë t`i thoja! E luta ta mbyllë telefonin që të thërras unë më vonë.

"Jo!, tha shkurt. E kemi ditur se një ditë kështu do të ndodhë. Tani a do t`i veshim dimitë a?... Nesër, - vijoi, do të hap të pame, dhe dua të të shoh këtu". Të nesërmen herët në mengjes, bashkë me Gani Sylën, Jashar Alinë dhe Mustafë Ademin, kemi shkuar në Gjermani te Baci Rifat. E kishim shumë të vështirë përballjen me njerëzit e mbetur të Epopesë-Jasharaj, me pjesëtarët e heroizmave më tronditëse dhe njëkohësisht më madhështore të kujtesës historike. Po me të parë qëndresën e Bacit Rifat, e te djemëve - Muratit, Bekimit e Lulit, jemi mbajtur edhe ne; qëndruam edhe ne përbri shkëmbinjëve të pathyeshëm të larë në lumenjë gjaku. Nuk besoj të gjendet penë e mprehtë që të përvijojë me gjithë dimensionet tronditëse një ngjarje që mban Vulën - Jasharaj. Vërtet nuk besoj.

Kam ndenjur derisa kanë përfunduar ngushëllimet. Njerëzit vinin duke qarë, dhe në vend që të ngushëllonin bacin Rifë dhe të tjerët, ngushëlloheshin vetë nga baci Rifë. Shpesh më bëhej se jam në ëndërr.

Sheradin Berisha: *Bac, pas luftës së përgjakshme në Prekaz, Qeveria e Bujar Bukoshit, në kuadër të fondit të 3%-it, ka organizuar aksionin e parë "Gjithçka për Drenicën", ndërsa në verën e atij viti organizoi aksionin e dytë me moton "Gjithçka për pavarësinë e Kosovës"! Në Gjermani u bë një përpjekje për bashkimin e të gjitha subjekteve shqiptare rreth këtij aksioni, por nuk u realizua dot, për shkak se Bujar Bukoshi e Isa Mustafa, si Ministër i Financave, kërkonin që ta menaxhonin këtë aksion nën siglën e qeverisë, me ato bonat e famshme 500, 1000 Dm / Frz, ndërsa LPK-ja dhe subjektet e tjera kërkuan që këto*

mjete t'i dedikohen UÇK-së! Dhe, më pastaj koha tregoi se ato mjete nuk u mblodhën për Drenicën, e aq më pak për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës! Si u organizuat ju në Zvicër?

Idriz Mehmeti: Po, u formua "Këshilli i Emergjencës" për këtë qëllim. Pas ngjarjes së Prekazit, njerëzit pyesnin si do bëjmë, ku të japim mjetet financiare, etj. Gjërat ndryshuan, por tanimë ishim vonuar shumë. Edhe pse tanimë ishte vonë, një para dite, Xhafer Shatri kishte thirrur një takim me përfaqësuesit e Fondit "Vendlindja Thërret", të ndjerët: Jashar Salihun dhe Xhavit Hoxhën, si dhe me përfaqësuesin e 'Fondit të Qeverisë' (3%-shit) për Zvicër Gani Hoxhën, bashkë me Gani Sylën, dhe me mua Idriz Mehmetin. Qëllimi, siç tha Xhaferi, ishte unifikimi i fondit të luftës (më vonë është quajtur Emergjencë). Foli shkurt dhe i qartë: "Meqë lufta ka filluar, ne s`kemi qenë të zotët të bashkoheshim gjerë më tani, të bashkohemi së paku nga ky çast e tutje". Dhe propozoi të formohet "Emergjenca", siç ishte formuar edhe në Gjermani. Dhe duke qenë se Gani Syla ka takt të punojë me masat, do të jetë kryetar i "Emergjencës". Po ashtu do të hapet "Fondi i Luftës", dhe të drejtën e menaxhimit të mjeteve të luftës do ta ketë njëri nga dy përfaqësuesit e Fondit 'Vendlindja Thërret'. Ata vetë do ta përcaktonin cili do të ishte përfaqësuesi i tyre; pastaj përfaqësuesi i 3%-it, Gani Hoxha, dhe i treti do të jetë Idriz Mehmeti.

Mund të them me përgjegjësi morale, se kjo marrëveshje është mirëpritur dhe mbështetur nga të gjithë pjesëmarrësit e atij takimi. Mirëpo, Jashar Salihu i ka kërkuar Xhaferit kohë, me sa di unë dy ditë, "sepse më duhet ta marrë pëlqimin e vartësit tim", -tha ai. Ndërsa Jashari, baca Xhavit Hoxha edhe ne të tjerët, pa përjashtim, po e përsëris, e kemi mirëpritur këtë iniciativë të ministrit Shatri, që ishte sa e nevojshme aq edhe e domosdoshme, edhe pse e vonuar. Po atë ditë është mbajtur një demonstratë e madhe në Bern, ku edhe është bërë publik emërimi i Gani Sylës në krye të "Emergjencës". "Emergjenca" u formua, por "Fondi i Luftës", siç propozoi Xhaferi, fatkeqësisht nuk u bë kurrë. Më vonë është spekuluar shumë për këtë iniciativë. Unë kurrë s`e kam kuptuar se kujt nuk i konvenonte unifikimi i forcës, qoftë financiare,

njerëzore e ushtarake! Kujtoj se të gjithë kishin pjesën e vetë të përgjegjësisë. Faji gjithmonë mbetet jetim. Po atë pasdite, derisa protestohej në Bern, më ka telefonuar Hashim Thaçi. “Unë u nisa me disa shokë -tha, shpresoj të mos vonohesh!" Rruga e mbarë - i thashë-, besoj se shpejtë do të shihemi!

Sheradin Berisha: *Pastaj, si rrodhën ngjarjet në muajt prill - maj 1998, a kishit aktivitete konkrete në këtë drejtim?*

Idriz Mehmeti: Po, e kam pasur një takim me kolonel Ahmet Krasniqin. Ishte fundi i marsit, apo fillimi i prillit 1998. Një mbrëmje bie telefoni!..E mora. Më duket njeri i panjohur!

"Jam Baca - tha. Kam nevojë të bisedoj me ty!"

"Po, - i thashë, për çfarë do bisedonim, ne nuk njihemi"!

"Do të jet me interes për Kosovën" - tha, - do njihemi"!

E caktuam kohën, ashtu siç u morëm vesh dhe u takuam. Ishte Kolonel Ahmet Krasniqi. U njohëm. Biseduam gjatë për shumëçka. Pos tjerash e pyeta se kush ia kishte dhënë numrin e telefonit tim!

"Xhafer Shatri" - tha. Xhaferi i kishte thënë se unë kam raporte të afërta me familjen Jashari, ndaj më kishte ftuar. "Nuk kërkoi shumë prej teje, - filloi të shprehte kërkesën koloneli. Nëse ma jep një fije të saktë të UÇK-së, të betohem se ti e ke kryer detyrën ndaj atdheut! Dhe kazermën e parë që do ta ngris do t`ia vë emrin Adem Jashari".

Sheradin Berisha: *Nga cila pozitë fliste kolonel Ahmet Krasniqi?*

Idriz Mehmeti: Gjatë bisedës e pyeta, kush jeni ju, dhe cili është roli i juaj? "Unë, tha ai, - jam Ministër i Mbrojtjes në Qeverinë e Republikës së Kosovës". "Po çfarë i ofron ti UÇK-së! - i thashë unë. Deri tash Qeveria nuk ka dhënë as më të voglën shpresë për diçka të tillë, pos llafeve"! Koloneli u përgjigj: "Deri tash unë s`kam qenë pjesë e saj, unë mund të flas nga tani e tutje!"

Sheradin Berisha: *Dhe, çfarë ndihme konkrete ofroi ai për UÇK-në?*

Idriz Mehmetin: E pyeta, a më thua më saktë çfarë ofron momentalisht për UÇK-në? "Mjete teknike në vlerë prej 5-6 ml.fr. (pesë-gjashtë miliona franka) - tha! Pare nuk jap, por teknikë luftarake sigurisht që po! Do të luftojmë bashkë - tha! Dhe vazhdoi: do ta çlirojmë Kosovën, e nëse jo, do ta ndezim flakë Ballkanin". Prezent ka qenë një koleg i tij, emrin nuk ia mbaj mend, mbiemrin e kishte Shkreli (siç më thanë ishte pilot, ushtarak). Ahmeti kishte lidhje gjaku me familjen e Aziz Zhilivodës. Unë jam një farë stërnipi i juaji - i thashë, dhe i shpjegova për lidhjen e dajëve të mi me Azizin.

"Si përfundim - tha, do të më japësh një lidhje me ndonjërin që vjen nga vijat e frontit, por që do të mund ta takoj këtu në Zvicër, ose eventualisht në Tiranë".

"Po - i thashë, e kam një lidhje të tillë dhe do ta jap pasi t`i tregoj atij se çfarë ofroni juve".

"Në rregull!" - tha.

Jemi takorduar, dhe në rastin e parë kur është kthyer Hashim Thaçi në Zvicër, kam shkuar e kam takur, dhe në detaje i kam shpjeguar për ofertën. Menjëherë e ka pranuar ofertën dhe më ka kërkuar ta organizoj sa më parë takimin me kolonel Ahmet Krasniqin. Një natë të vonshme jemi takuar në banesën e Ahmet Krasniqit në Cyrih. Deri në mëngjes kemi biseduar. Në të vërtetë ata bisedonin, e unë i dëgjoja. Kanë analizuar gjithanshëm çfarë duhet dhe çfarë munden bashkarisht të bëjnë. Mund të them se në shumicën e gjërave kanë pasur mirëkuptim të dyanshëm. Kanë këmbyer numrat e telefonave, me të cilët tani e tutje, vetëm, dhe pa ndërmjetsimin tim do të vazhdonin bashkëpunimin. Ky ka qenë takimi i parë midis tyre. Deri në qershor 1998, që të dy më telefononin dhe më falënderonin për mundësinë që u kisha dhënë të njihen e të bashkërendisin veprimet luftarake. Vërtet ndihesha mirë kur dëgjoja se bashkëpunimi në mes tyre ecte mirë.

Sheradin Berisha: *Dhe, a pati bashkërendim të mirëfilltë për fuqizimin e UÇK-së?*

Idriz Mehmeti: Fatkeqësisht jo! Fillimi i qershorit ishte dhe fillimi i ftohjes së raporteve të tyre. Të dy më kanë thënë në telefon se, punët kishin filluar të mos ecin siç ishin marrë vesh. Çfarë t`iu thosha, a mos ishin të vegjël, apo ndoshta mendonin se kanë hyrë në lojë e jo në luftë! Njerëz të çuditshëm!

Sheradin Berisha: *Megjithatë, pas epopesë së lavdishme të Prekazit, populli shqiptar në trojet e veta etnike dhe në të gjitha shtetet e perëndimit ku jetonte u zgjua dhe përmes protestave i tregojë botës, se të gjithë jemi UÇK! Ndërkohë u shtua mobilizimi për ta ndihmuar UÇK-në financiarisht dhe fizikisht, duke iu bashkuar radhëve të saj. A u bë një mobilizim i tillë edhe në Zvicër?*

Idriz Mehmeti: Po, pas Epopesë së lavdishme të UÇK-së, Epopesë së Jasharajve legjendarë, qëndrimi jashtë atdheut më s'kishte kurrfarë kuptimi, ndaj erdhi momenti i fundit që edhe unë të merrja vëndimin e duhur! T'i bashkohem radhëve të saj!

Sheradin Berisha: *Cili ishte rrugëtimi juaj në këtë mision çlirimtar?*

Idriz Mehmeti: Në fillim të qershorit 1998, bashkë me Gani Sylën, Enver Garën dhe Bedri Dervishin kemi shkuar në Tiranë dhe jemi vendosur në banesën e Gani Bunjakut për disa ditë. Gani Koci më kishte njoftuar me telefon se Besimi (vëllai im) ishte në Tropojë, kishte shkuar me një grup vullnetarësh për armatim. I kërkova Azem Sylës një makinë që të na çonte mua, Enverin dhe Bedriun t`i takonim Besimin dhe shokët e tij, që kishin ardhur për t`u pajisur me mjete luftarake. Azemi na siguroi një xhip dhe shoferin. Kemi shkuar në Tropojë, dhe meqë arritëm vonë, takuam shumë bashkëvendas tanë, po edhe vullnetarë të tjerë; në mesin e tyre edhe Komandant Bekim Berishën - Abenë. Besimin atë mbrëmje nuk e gjeta, e takova të nesërmen. E përqafova fort, madje edhe lotë më dolën, po i fshiva shpejt që të mos m`i shohë. Kemi ndenjur me

të shumë pak. Ai dhe grupi i tij së shpejti do të niseshin për rrugë. E pyeta: - Besë, a po më mirrni edhe mua?

Jo! - tha, - rruga është e gjatë dhe e mundimshme, ti nuk mund ta përballosh. Të përcjellin ty këta shokët e tu, ndoshta në ndonjë rrugë më të shkurtër. Sa të rëndë e kisha ndarjen prej tij! Nuk i dihej, luftë ishte!

Sheradin Berisha: *Ku vajtët pastaj…?*

Idriz Mehmeti: Vonë jemi kthyer në Tiranë. Disa ditë kam qëndruar në Tiranë. Gjatë këtyre ditëve kam takuar shumë njerëz, gjithnjë duke u përpjekur për unifikimin e angazhimeve që kërkonte koha (lufta). Kam takuar Azem Sylën, Hydajet Hysenin, Arbër Xhaferin, Shaip Bilallin, Xhafer Shatrin, Rasim Kiçinën, Naser Kukën, Xun Qetën, Gani Veselin e shumë të tjerë. Seicili në mënyrën e vet përpiqej të bënte diçka! Një pasdite ndejtëm bukur gjatë me Rasim Kiçinën (Tajsonin siç e quanin shokët e tij). Ishte një djalë shumë i qetë, fliste shumë pak.

Sheradin Berisha: *Bac, atë kohë në Tiranë ishte edhe kolonel Ahmet Krasniqi, a patët takime me të?*

Idriz Mehmeti: Po, e kam takuar edhe kolonel Ahmet Krasniqin dhe kam biseduar gjatë me të. Krejt në fund troç më tha: "Nuk po bëhen të sinqertë ata shokët e tu, unë u jap teknikë luftarake, e ata shkojnë edhe në Zhilivodë e më shajnë. Shkurt tha: Kjo ka bërë që nuk do ta vazhdoj bashkëpunimin me ta".

Dy herë jam takuar vetëm për vetëm me të. Herën e fundit insistova që, pavarësisht pengesave evidente, të vazhdonte ndihmën dhe bashkëpunimin me luftëtarët e UÇK-së. Por e vërejta se kishte pengesa edhe nga shefat e tij në Prishtinë e në Tiranë, edhe pse ai vet nuk e thoshte! Meqë ai nuk jeton më, dihet pra fati i tij, me keqardhje më duhet të them çfarë i pata thënë krejt në fund: "Bacë, i thashë, jemi në luftë, s`ndërpritet bashkëpunimi për një të sharë, edhe pse të kanë sharë në Zhilivodë. Por, dyshoj, të paskan disiplinuar, ja Rugova, ja Bukoshi, ja të dy bashkë". "Jo, tha me plotë gojën, për luftën nuk i pyes asnjërin".

Po, të qesin prej loje, i thashë, o bacë"! "Jo, tha, pa au çjerrë maskat në televizion s`do mund të ndahen prej meje!" Edhe Anton Kola kështu diçka thoshte dikur - i thashë, por nuk doli e tija. Edhe ai ka qenë në lojë dikur, po ku është sot, e pyeta! "Kjo s`ka rëndësi për mua", tha.

Shpresoja se kur të vinte Hashimi në Tiranë do t`i takoja përsëri bashkë dhe do të tejkaloheshin mospajtimet. Kjo nuk ndodhi, sepse rasti i parë që m`u dha, u futa në Kosovë. Dhe kurrë më fizikisht nuk e takova Kolonel Ahmet Krasniqin. Disa herë më ka thirrur në telefon, sa isha në Drenicë. Gjithmonë është përpjekur të gjejë rrugë e ta ndihmonte UÇK-në. Edhe taborri i tij kishte brenda plot hilexhinjë. Shumë prej tyre i njihja, ndërsa ai personalisht, për mendimin tim, ishte shumë i sinqertë. Tani, kujt i pengonte fuqizimi i UÇK-së, unë nuk e di, por e di, se Ahmet Krasniqi nuk e meritonte një përfundim të tillë. Ai e donte Kosovën, punonte për Kosovën, dhe i duhej Kosovës.

Sheradin Berisha: *Bacë, tashmë ishe bërë gati për të hyrë në Kosovë. A mund ta përshkruani rrugëtimin tuaj?*

Idriz Mehmeti: Nga mesi i qershorit 1998 u ngjita në Krumë të Hasit me një grup vullnetarësh. Pak ditë qëndrova në banesën e Haki Hajdarit, (e quanin Haki Drenica). Derisa kam qëndruar në shtëpinë e Hakiut e kam takuar përsëri Komandant Bekim Berishën - Abenë. Ai kishte ardhur sërish me një grup tjetër për t`u armatosur. Po këtu e kam takuar Azem Sylën dhe Xheladin Gashin, (Komandant Plakun), siç e quanin. Me Xhelën e kam pasur një përplasje sa ishim në Zvicër, dhe më duhet ta sqaroj. Unë asnjëherë nuk jam shprehur kundër Fondit "Vendlindja Thërret", mirëpo nuk e kam kundërshtuar as "Fondin e Qeverisë" Bukoshi. Dhe kjo e ka penguar Xhelën, në dy raste: në St. Gallen dhe në Bern. Megjithatë, edhe pse e kishim pasur atë përplasje, kemi bashkëpunuar shumë mirë.

Unë kam zgjedhur një pushkë Automatike, 1000 fishek dhe 6 Bomba. Aq besoja se kisha fuqi për të mbajtur, sado që lakmoja më shumë. Të tjerët e kanë marrë edhe nga një çantë me municione rezevë, kështu ishte rregulli. I kemi pastruar mirë armët dhe pritnim urdhërin që të futeshim

në Kosovë. Këtë lidhje ma pati ofruar personalisht Hashim Thaçi, nga se shkaku i kondicionit nuk më preferuan që të udhëtoja me vëllaun Besimin e me shokët e tij, të cilët udhëtuan nga Tropoja për në Drenicë 4-5 ditë para meje.

Një ditë para se të nisemi për në luftë e kam takuar Rexhep Selimin, Komandant 10-shin (Dhjetshin) dhe axhën e tij, Vesel Selimin, të cilin e njihja edhe më parë. Rexha ma pati dhënë një uniformë shumë të mirë amerikane. Përgjegjës i udhëtimit ishte Komandant Abedin Rexha - Sandokani. Kemi udhëtuar 23 veta në një grup. Do përpiqem t`i them emrat e atyre që kam arritur t`i gjej, pavarsisht që ka ikur kohë e gjatë. Disa nga ata, para se të fillojmë bashkëbisedimin tonë, mi ofroi njëri nga bashkluftëtarët tonë, Agron Gërvalla, vëllai i Dëshmorit të Kombit Nuredin Gërvallës, të cilin e falenderoj shumë!

Përgjegjës rrugëtimi, siç thash, ishte komandant Abedin Rexha - Sandokani. Shoqërues, (përcjellës), ishte Xheladin Dauti nga fshati Golaj-Has-Shqipëri, i vrarë më vonë në vjeshtën e 1998-tës, në fshatin Gërçin, po ashtu duke shoqëruar ushtarë të UÇK-së për në luftë! Pastaj unë, Hadije Binaku-Drenicë, vinte nga Gjermania, ishin dy burra nga trojet Shqiptare të Maqedonisë, Taipi dhe Vardari, fatkeqësisht nuk më kujtohen mbiemrat e tyre. Muhamet Krasniqi nga Prizreni, Agron Gërvalla, Dedë Abazi, Sokol Marku dhe Zef Ndrejaj, (Dukagjinas). Shaban Musliu, ish oficer i armatës jugosllave, Skënder Shkodra dhe Musë Aliu nga Gjilani. Fahri Makolli nga Podujeva, Imer Imeri-Komogllavë, Shemsi Dodaj - Kamenicë, Agron Vella - Mitrovicë, Roberti nga Klina, Mentor Morina e ca çuna të rinjë, kryesisht drenicas që kishin ardhur me Sandokanin për t'u pajisur me teknikë luftarake. Më vjen keq që nuk i mbaj mend dot emra e tyre!

Binte shi. Ishte errësuar më herët se normalisht. Jemi nisur nga fshati Vlahnë afër zonës kufitare. Ngadalë dhe me vigjilencë na printe Komandant Sandokani. Udhëtimi ishte i vështirë. Shiu s'pushoi gjatë gjithë natës. Shiu në njërën anë na lehtësonte punën e sigurisë, por në anën tjetër e vështirësonte rrugëtimin. Disa nga ata që na kishin frikën,

(mua dhe Hadijes), se nuk do të mund ta ndjekim kolonën, i lëshoi forca para nesh. Siç e thashë edhe më sipër, për shkak të vështirësive që imponoi moti i ligë, nuk arritëm sipas kohës së llogaritur (pa zbardhur drita) të futemi në Bazën e planifikuar. Kështu që fillimisht kemi hyrë në shtëpinë e Mehmet Osmanit, në fshatin Goden. Ky burrë bujar na i ka ngarkuar pajisjet në një karrocë me kalë dhe pa fije hezitimi na ka dërguar në bazën e UÇK-së; më saktë në shtëpinë e familjes së Hajdar Gutajt, në fshatin Gërçinë. Pas lufte kam dëgjuar se gjatë bombardimeve, Mehmet Osmani është pushkatuar nga hordhitë serbe. Në familjen Gutaj kemi pushuar, kemi fjetur paksa dhe, kur u zgjuam, për mëngjes na kishin përgatitur petulla të freskëta. Si hëngrëm mëngjes kemi vazhduar rrugëtimin me një kamion të mbuluar. Kemi kaluar shumë afër një pike ushtarake serbe, që po të kërkonin legjitimimin tonë, sigurisht do shkëmbenim zjarr. Kështu na pati urdhëruar Komandant Sandokani.

Pastaj kemi arritur në fshatin Drenovc të Rahovecit dhe pas një pushimi të shkurtër kemi vazhduar rrugëtimin drejt bazës ushtarake të UÇK-së, në Turiqevc të Skënderajt; në bazën e komandant Sandokanit.

Sa kemi zbritur nga kamioni i kam takuar dy ish shokë të mi të vjetër: vëllezërit Avdi e Ali Hoti nga Jashanica e Klinës. Kur më kanë parë, të dy kanë shtirë nga një breshëri plumbash në ajër. Më kanë përqafuar dhe më uruan mirëseardhje. Mandej kemi shkuar në fshatin e Komandant Sandokanit. Na ka vendosur në një shtëpi, ku kemi pushuar, dhe të nesërmen m'i ka dhënë dy ushtarë, një xhip e më kanë përcjellur deri në Likovc, në Shtabin e UÇK-së. Në Likovc, njeriun e parë që e njihja dhe e kam takuar ishte Ramadan Gashi, pastaj Murat Musliu e më vonë Bedri Deliu. Bashkë me Danin jam paraqitur tek Komandanti i zonës së Drenicës, Sylejman Selimi - Sulltani. Gjeneral Selimi, pasi më uroi mirëseardhjen, më pyeti ku dëshiroja të shërbeja si luftëtar!

"Ku të jetë e nevojshme" - i thashë!

"Shko pusho pesë ditë e çmallu me familjen, - tha, se nuk jeni parë moti, pastaj do të sistemohesh tek pika "Arra", në Prellovc, tek Jakup Nura.

Por ne do shihemi prapë, ti do lëvizësh ku të ketë nevojë më tha. Pastaj shtoi: nëse nuk je mërzitur fort, prit edhe pak, nuk do vonojë shumë e do të vijë një shok i yti i vjetër.

"Po cili" - e pyeta?

Syla qeshi dhe shtoi: "Baci Fehë"!

Sa u gëzova! Vërtetë nuk vonoi shumë dhe erdhi i madhi Fehmi Lladrovci, shoku im, tani komandant i Brigadës 114. Sa më ka parë, më ka thirrur: "O Idriz Mehmeti, paske ardhur a!" Më ka përqafuar fort! Jemi ulur nën hijen e një lisi dhe kemi biseduar gjatë.

"Shumë kohë kemi kaluar bashkë - tha Feha, paske ardhur edhe vdekjen ta bëjmë bashkë"!

"Jo! - i thashë me të qeshur, deri këtu gjithnjë ishim bashkë, po vdekjen nuk do ta bëjmë bashkë. Në atë moment m'u përfytyrua Fehmi Lladrovci dëshmor. Jam shumë i sigurt në këtë, sepse shihja në sytë e tij vullnetin dhe dëshirën për të rënë për Atdheun. Po ai ra heroikisht tre muaj më vonë, në ofensivën e Shtatorit.

Pas dite ka ardhur vëllai im, Selimi, dhe prej Likovci kemi kaluar me një makinë nga dajtë në Verbovc, për një vizitë të shkurtër, pastaj kemi shkuar në shtëpi, në familjen time. Prapë ndjenja të përziera, gëzim, lot, përqafime, çmallje. Ishin katër vite e gjysmë që nuk ishim parë. Nëna, baba, axhallarët, familja, kushërinjtë, miqë, shokë. Pesë ditë pandërprerë kulla ishte plotë e përplotë... Më vizituan, ndër të tjerë: Gani Koci, Ramadan Gashi, Bedri Deliu, Murat Musliu, Mulla Osmani i Likofcit, prof. Imer Halimi (ish mësimdhënës i imi) dhe kushëriri i tij Emin Halimi. Sa mirë më erdhi kur pash edhe prof.Ymerin të rreshtuar në shërbim të luftës, po sepse pjesëmarrja e një intelektuali kishte vërtetë peshë në ngritjen e moralit të çunave të rinjë, ushtarë, e prof. Ymeri kishte gradën e Doktorit të Shkencës! Të gjithë këta që përmenda kryenin detyra të caktuara në kuadër të UÇK-së… Vërtetë ishte kënaqësi, pasi gjithë familjen e gjeta në shërbim të luftës. Në radhët e

UÇK-së i gjeta edhe vëllezërit e mi: Besin, Skendën e Selimin, pastaj djemtë e axhallarëve: Januzin e Arsimin, e më vonë, pasi u shpall mobilizimi i përgjithshëm, u kyçën Gëzimi dhe Rrustemi!

Sheradin Berisha: *Bac, pas çmalljes me familjarët dhe miqtë tuaj, me urdhër të komandant Sylejman Selimit jeni sistemuar te pika "Arra" në Prellovc. Cila ishte detyra juaj ushtarake në këtë pikë të UÇK-së?*

Idriz Mehmeti: Pas pesë ditë pushimi, pritje e përcjellje mysafirësh, jam paraqitur në bazën ushtarake, në pikën "Arra", te komandanti i kësaj Kompanie, Jakup Nura, njëri nga bashkëluftëtarët e parë të Komandant Adem Jasharit. Detyra ime konkrete ishte: ushtar i thjeshtë lirie, kudo që kërkohej kontributi im, kudo që eprorët e mi kërkonin, unë isha aty, nga komandanti i pikës ushtarake "Arra" në Prellofc, Jakup Nura, gjer tek Komandanti i Zonës Operative të Drenicës, Sylejman Selimi!

"Pika Arra" ishte vendosur në shtëpinë e Sali Xhemës, kushëri i kom. Jakupit dhe mik i familjes time. Si nga Jakupi, ashtu edhe nga ushtarët e kësaj pike ushtarake jam pritur shumë mirë. Edhe këtu ka pasur shkrehje armësh si shenjë përshëndetjeje. Sa u takuam me ish shokun tim, Murat Mehmetin, nga emocionet, Murati filloi të qante. "Prapë bashkë!", tha. "Po i thash, bashkë…"

Pas sistemimit tim në radhët e UÇK-së, më bëhej se kam lindur sërish. Kohë pas kohe e vizitoja Likovcin, takoja shokë të vjetër, si Danin, Bedriun, Muratin etj. Dani tani ishte emëruar nga UÇK-ja kryetar për të drejtuar Komunën e Skënderajt. Ai kishte një zyrë në lokalet e Shtabit të UÇK-së, në Likovc, ndërsa Murat Musliu udhëhiqte sektorin për informim të Komunës, por edhe zhvillimet Ushtarake në atë zonë. Ndërkohë kam takuar Berat Luzhën. Shpesh kemi qëndruar bashkë. Berati ishte i ngarkuar të udhëheq sektorin për informim në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm. Pas ca ditësh, bashkë me Beratin kemi takuar zëdhënësin e UÇK-së, z.Jakup Krasniqin dhe Ramë Bujën, në shtëpinë e ish mësuesit tim, më vonë edhe shok burgu, Taf Rrukiqi.

Sheradin Berisha: *Në verën e vitit 1998 forcat ushtarake-policore serbe ndërmorën një ofensivë të gjerë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Si e përballuat këtë ofensivë në Zonën e Drenicës?*

Idriz Mehmeti: Ishte korriku i vitit 1998. Vëzhguesit njoftojnë se ka lëvizje të forcave serbe nga baza e tyre në kodër të Polacit. Vet i shtati kam shkuar në ndihmë të pikës së Polacit, e cila kishte një vijë zjarri afër "Trafos Elektrike". Mund të them se, kishin bërë istikame të mrekullueshme, nga rruga, afër shtëpisë së Kadri Kocit, në të cilën edhe ishte vendosur efektivi i kësaj pike, gjerë tek "Trafoja Elektrike", për të vazhduar tek një bodrum në anën tjetër të lagjes Koci (nuk di i kujt ishte ai bodrum, por e di se ato ditë ishte shpëtimi ynë). Forcat serbe kanë filluar të lëvizin në drejtim të Morinës. Nga pozicionet tona është hapur zjarr... Ata u ndalën dhe filluan granatimet. Ishte hera e parë që edhe personalisht shkëmbeja zjarr me forcat serbe. Kjo vijë zjarri është mbajtur tri ditë. Që ditën e parë një pjesë e forcave serbe kishin arritur të depërtonin në afërsi të fshatit Rezallë. Por në Morinë i priste Vesel Oruçi (Ramboja i Rezallës) me shokë dhe me të vëllain Samiun e me Rifat Mëziun, bashkëluftëtarin e pandashëm me të cilin u ndamë vetëm atëherë kur Rifati pat rënë në kufi me Mujën, me Beqën e me shumë trima të tjerë. Qëllimi i forcave serbe ishte depërtimi në Likovc. Forcat serbe nuk arritën të thyejnë pozicionet e Rambos, sado që teknikën luftarake e kishin shumë modern; iu mungonte morali, ndërsa Ramboja nuk e kishte teknikën e tyre, por e kishte moralin. Atij shpesh i shkonte dorësh që të vriste mercenarë të ardhur nga Rusia, (oficerë rus), që kishin ardhur t`i ndihmonin falangat e Sheshelit, i cili kishte deklaruar se së shpejti do të pinte kafe në Likovc.

Për fat të keq, kësaj radhe forcat serbe depërtuan në Likovc, por nga ana e Llaushës, andej nga nuk e priste askush, për shkak se tereni ishte shumë i vështirë. Megjithatë, patën arritur të depërtojnë. Por forcat tona i sulmonin çdo ditë dhe përsëri u kthyen në Likovc. Ditën e tretë të këtyre luftimeve, me mua, Januzin (djali i axhës Eshref) dhe disa ushtarë të Sabit Prekazit nga Qirezi, ka ardhur edhe babai im. Ai e kishte pushkën e tij, 48-shen, të cilën gjatë, shumë gjatë e kishte ruajtur për këtë ditë.

Sheradin Berisha: *Bac, para se të vazhdojmë rrjedhën bisedës, të ndalim shkurtë të një detaj që theksuat më lartë. Ju nënvizuat se, Berat Luzha "ishte i ngarkuar të udhëheq sektorin për informim në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm"! Dihet mirëfilli se "Radio Kosova e Lirë" bashkë me agjencinë "Kosovapress" është themeluar me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, dhe këto dy medie të luftës çlirimtare kanë nisur punën më 4 janar 1999. A mund të na shpalosni me pak fjalë këtë çështje të rëndësishme?*

Idriz Mehmeti: Po, Berat Luzha ishte i ngarkuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së që ta aktivizonte Drejtorinë e SHP për Informim. Nuk e di nga ishte siguruar një shtypshkronjë, por ajo që dua të them, është se shtypshkronjën e kanë sjellë me një traktor në shtëpinë time, Fehmi Lladrovci, Halim Krasniqi (vëllai i zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqit) dhe Fatmir Mehmeti nga Gjilani. Bashkë me vëllezërit e kishim ndërtuar një shtëpi të re, e cila që nga vitet e `90-ta kishte shërbyer për mësim, si shkollë e ciklit të ulët e fshatit. Shtëpia kishte një dhomë të madhe, e cila ishte planifikuar për sallon, por ishte e pa rregulluar akoma. Për tri katër ditë e kemi meremetuar: unë, Ramadan Mehmeti e Abedin Gashi (Abedini ishte djali i vëllait të Danit, dhe djalë i motrës së Adem Jasharit). Aty, përveç shtypshkronjës patëm vendosur edhe tre shtretër, kishte vend të mjaftueshëm. Shpeshherë kemi fjetur në atë lokal. Ndërsa gjatë dhe pas ofensivës serbe të Shtatorit të vitit 1998, kati i parë i asaj shtëpie ka shërbyer si spital ushtarak (dy muaj). Dhe gjatë gjithë kohës sa kanë qëndruar të plagosurit në shtëpinë tonë, janë përkujdesur nëna dhe kunatat e mia, sidomos vëllai im Skenda me të shoqen Kimeten, (Kimetja është motra e dëshmorit Avni Hajredini nga Koshtova e Mitrovicës).

Sheradin Berisha: *Të rikthehemi të përballja e UÇK-së me ofensivën serbe! Forcat pushtuese ushtarake-policore serbe, pas një pauze të shkurtër, kanë vazhduar operacionin e "tokës së djegur" edhe në shtator të vitit 1998. Në këtë përballje të përgjakshme, në fushëbeteja bien shumë dëshmorë, në mesin e tyre dhe Fehmi e Xhevë Lladrovci (më 22*

shtator 1998). Si rrodhën ngjarjet në këtë situatë të rëndë për popullin tonë?

Idriz Mehmeti: Po, më kujtohet ofensiva e shtatorit. Herët në mëngjes filluan granatimet. Forcat serbe kishin sulmuar Drenicën përgjatë magjistrales nga 'Kroni i Mretit', nëpër Drenas, Skënderaj deri në Mitrovicë. Pastaj matanë Qyqavicës, nga Mitrovica deri në Bellaçevc e Sllatinë, për t`u mbyllur harku prap te 'Kroni i Mretit'. Njësitë tona granatoheshin nga të gjitha anët, ndërkohë që kishin mësyrë shumë tanke dhe mbi 100 automjete të ndryshme të blinduara, vetëm nga pjesa Jugperëndimore e Qyqavicës. Luftime të përgjakshme ka pasur edhe në distanca të vogla, disa metërshe...

Më kujtohet trembëdhjetëshja e famshme 'institucionaliste' me Gjergj Dedën, Mehdi Bardhin me shokë, të cilët kishin ardhur dy-tri ditë më herët në Drenicë për një "*mision",* por për mua të paqartë në rrethanat e kohës. Thjeshtë, *misioni* i tyre qëllim të vetëm kishte propagandën kundër luftës. Ata ishin ndaluar me urdhërin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe ishin pyetur për qëllimin dhe arsyet e prezencës së tyre në këtë pjesë, në këtë zonë ku po zhvilloheshin luftimet. Disa sish, duket se ende mendonin se lirinë do ta fitojmë me lutjet e të premteve në "Xhaminë e Madhe" të Prishtinës. Megjithatë, ata tanimë ishin liruar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, por kishin mbetur në këtë zonë për shkak të luftimeve që zhvilloheshin dhe të pamundësisë për t`u larguar nga kjo anë.

Sheradin Berisha: *Bac, meqë përmendët ndalimin e "13-shes institucionaliste" po ndalemi pak te kjo ngjarje! Unë në arkivin tim ruaj një kumtesë të lëshuar më 23 shtator 1998 nga "Drejtoria e policisë ushtarake të UÇK-së", të cilën e ka botuar edhe ZiK-u, organi i LPK-së.*

Në kumtesën e DPU të UÇK-së lidhur me këtë ngjarje thuhet: "Duke u bazuar në të dhënat e Shërbimit Informativ të UÇK-së, për rolin e tyre përçarës partiak grupor "institucionalist" antiluftë çlirimtare, propagandës që ata në terren po zhvillonin për dorëzimin e armëve dhe për një zgjidhje të përkohshme të statusit politik të Kosovës në kuadër të

Serbisë, policia ushtarake e UÇK-së, me datë 20.09.1998, rreth orës 12:15, në fshatin Qirez të Drenicës ndërmorri masën e arrestit ndaj 13 përfaqësuesve partiakë "institucionalistë" e sindikalistë. Pas kryerjes së hetimeve në harmoni me normat e luftës dhe të rregullores së punës të policisë ushtarake të UÇK-së këta përfaqësues, më datë 23.09.1998, u liruan nga arresti, ndërsa ndaj Gjergj Dedajt, kryetar i Partisë Liberale të Kosovës dhe nënkryetar i të vetëquajturit Parlament i Kosovës dhe Agim Krasniqit dhe Mehdi Bardhit, funksionarë të lartë të LDK-së, edhe pse u liruan, do të vazhdojë procedura e hetimeve deri në marrjen e vendimit tjetër nga organet kompetente të UÇK-së."

Tani mund të vazhdoni aty ku mbetët, për rrjedhën e ofensivës...!

Idriz Mehmeti: Po, ditën e parë të ofensivës së shtatorit isha në luftime në pjesën jug-përendimore të Qyqavicës, në mes të fshatrave Prekaz, Mikushnicë, Prellovc, Beqiq dhe Dubovc. Ishte plagosur rëndë komandanti i kompanisë tonë, Jakup Nura. Në anën tjetër, kisha marrë obligim që në mbrëmje ta strehoja Jakup Krasniqin me shokë. Përveç luftimeve tepër të ashpra me forcat serbe, kishte një zhvendosje të popullsisë në përmasa të mëdha. Ishte mbërthyer gryka e Qyqavicës! Digjeshin jo vetëm shtëpitë, por edhe toka e Drenicës. Në mbrëmje, në fshatin Prellovc e kam marrë një plakë me një vajzë të plagosur dhe i kam dërguar te mjeku Fadil Beka, i cili kishte kaluar me spitalin ushtarak nga Gradica në shtëpin tonë. Po ashtu edhe Dr. Naim Bardiqi me ekipin e tij jepnin maksimumin që mund të jepej në ato rrethana. Tani jo vetëm shtëpia jonë, por spitale ishin bërë pothuaj të gjitha shtëpitë e lagjës sime, sepse ishin mbushur me të plagosur.

Përveç mjekëve, Fadil Beka e Naim Bardiqi e ndjej të nëvojshme të falenderoj përsonelin e Spitalit Ushtarak, që në ato rrethana në shtëpinë tonë, për më tepër se gjashtë javë, bënë të pamundurën të shpëtonin të plagosurit: Abedin Bujupin, tani dëshmor i Kombit e Driton Gashin nga Arllati i Drenasit, Hyra Istogun nga Palluzha, Mevlude Hoxhën, Agim Hoxhën e Sami Nurakun nga Plluzhina, Meritën, Rifadijen, Ilmi Januzin e Lirimin nga Likofci, Arifja, Sebahaten, por edhe kunatat e mija

Kimetja e Lulja. Nuk duhet harruar kontributin shumë të çmuar të mjekëve Lec Gradica, Dr.Shpëtim Robaj, Shaban Hasi për sa kohë që Spitali Ushtarak ishte në Likovc e në Gradicë.

Gjatë gjithë ditës ishte zhvilluar luftë e ashpër, ku kishim edhe të rënë në fushëbeteja. Në pikën "Shkaba", njësitë tona pasi kishin zbrapsur tri tentime të forcave fashiste serbe për të depërtur në zonë, bie heroikisht edhe vetë komandanti Fehmi Lladrovci, së bashku me Xhevën (gruan e tij), me Fatime Hetemin nga Bistrica e Shalës - bija e gjakut të Kadri Bistricës, Shefqet Zekën nga Prishtina, Skënder e Behxhet Karaxhën nga Çikatova. Ndërsa në kullën e tij, mu si Oso Kuka, ka rënë edhe Hamit Lladrovci, babai i luftëtarit Sabit Lladrovci. Sabiti njihet për trimëri të pashoqe, por që kurrë nuk bëri llafe. Bëri punën e luftëtarit të paepur dhe kaq.

Me këtë rast morëm një goditje të fortë, por luftën e vazhduam. Edhe në ditët në vijim, janë zhvilluar luftime të përgjakshme. Shumë na u vranë, ndër ta edhe Doktor Leci, Ajet Rrukiqi - ish shoku im i burgut, Enver e Murat Haliti nga Luboveci (nipat e Halit Bajramit, bashkëluftëtar i Azem Galicës), si dhe nipi Adem Lushtaku nga Prekazi. Gjatë gjithë kësaj ofensive, bashkë me Besin kam qenë në shoqërim të zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, Ramë Bujës e Berat Luzhës. Shokët e luftëtarët janë të dhimbshëm, ata nuk qahen, nuk vajtohen as nuk harrohen.

Sheradin Berisha: *A morët pjesë në varrimin e komandantit Fehmi Lladrovci me bashkëluftëtarët e tij?*

Idriz Mehmeti: Po, edhe 100 vjet po t'i bëja, nuk do ta harrojë kurrë ditën e varrimit të shokut tim, mikut tim, komandantit të Brigadës 114-të, Fehmi Lladrovci, dhe bashkëluftëtarëve të tij. Atë ditë më është dukur sikur e kam varrosur një pjesë të zemrës sime. Asllan Fazliu nga Gradica, njëri ndër bashkëluftëtarët më besnik të Fehës, në detaje më ka treguar ngjarjen e rënies së Fehas, Xhevës, Fatimes, Shefqetit, Skënderit e Behxhetit. Pas pesë-gjashtë muajsh edhe Asllani do të bjerë në fushën e nderit. Asllani ishte vërtetë Asllan, i urtë i fortë, sy patrembur! Edhe ai

shkoi te baci Fehë, dhe me vete mori vëllain, Mehdiun dhe axhën e tij Milazimin.

Sheradin Berisha: *Si përfundoi ofensiva e shtatorit 1998?*

Idriz Mehmeti: Ofensiva e shtatorit përfundoi me tërheqjen e forcave serbe, por prapa lanë tokën e djegur, lanë edhe shumë varre. UÇK-ja edhe pse kishte marrë goditje serioze, ajo sërish mori pozicionet e saja dhe me disiplinë të madhe filloi konsolidimin. Edhe unë bashkë me të tjerët kam kontribuar në ngritjen e serishme të Brigadës 114, e cila tani e tutje me krenari do ta mbante emrin, "Brigada 114 - Fehmi Lladrovci". Komandant i kësaj brigade u emërua Ilaz Kodra nga Prekazi, ish luftëtari i komandant Adem Jasharit, tani dëshmor i kombit. Pas ofensivës së shtatorit, SHP i UÇK-së ka bërë riorganizimin dhe strukturimin e organikës ushtarake nga skuadra deri në Brigadë.

Sheradin Berisha: *Bac, në nëntor 1998, në kohën kur UÇK-ja po ristrukturohet, ju vendosët të ktheheni te familja në Zvicër! Si u këthyet në Zvicër, dhe me çfarë aktivitetesh u morët në periudhën dhjetor 1998 - mars 1999?*

Idriz Mahmeti: Nga fundi i nëntorit, pas marrëveshjes për armëpushim, të cilën forcat serbe kurrë nuk e respektuan, nën përcjellje të vetë HashimThaçit deri në fshatin Lubizhdë, ka shkuar në Shqipëri e pastaj jam këthyer në Zvicër, për të qëndruar atje deri në fillim të prillit 1999, kur sërish iu bashkova radhëve të UÇK-së. Por tani në zonën kufitare në veri të Shqipërisë. Gjatë kohës sa qëndrova në Zvicër jam përpjekur, si gjithmonë, të jem argat në shërbim të mbështetjes së gjithanshme të vendit tim. Me shumë bashkatdhetarë kam marrë pjesë në demonstratën, e zhvilluar në Rambuje (shkurt 1999), gjatë kohës së mbajtjes së Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje. Pastaj gjatë raundit të dytë të bisedimeve që u zhvilluan në Paris (mars 1999), dy ditë kam qëndruar atje bashkë me Gani Sylën, Jashar Alinë dhe Mustafë Ademin. Me të gjithë pjesëtarët e delegacionit tonë jemi takuar, madje kemi pirë edhe kafe, përveç Ibrahim Rugovës dhe Bukoshit. Ishte shumë interesant takimi me Gjergj Dedën. Mund të them, isha i befasuar çfarë

kthese pozitive kishte bërë z.Deda, nga koha kur ishte në Drenicë (gjatë ofensivës serbe). Ai atëherë akoma nuk e dinte se ka qenë mysafir intersant, në kullën time; nuk po më njihte fare, bile më fliste me admirim për mikpritjen bujare të një plaku në Drenicë, pa e ditur se ai plaku, ishte babai im!

Sheradin Berisha: *Bac, më 31 mars 1999 SHP i UÇK-së shpalli Mobilizimin e Përgjithshëm. Më lartë theksuat se në fillim të prillit, sërish iu bashkove radhëve të UÇK-së, por tani në zonën kufitare në veri të Shqipërisë?*

Idriz Mehmeti: Po ashtu është! Menjëherë pas shpalljes së mobilizimit nga SHP i UÇK-së, më 01.04.1999, bashkë me Gani Sylën, Jashar Alinë dhe Naser Tupellën, nga Zvicra jemi nisur për në Tiranë, me qëllim që të futemi në Kosovë, për t'iu bashkuar radhëve të UÇK-së!

Sheradin Berisha: *Me kë u takuat fillimisht në Shqipëri?*

Idriz Mehmeti: Me 4 prill në Tiranë kemi vizituar Jakup Krasniqin, (tashmë zëdhënës i qeverisë së përkohshme, në krye me Hashim Thaçin), dhe Azem Sylën -Ministër i Mbrojtjes në QPK. Nga Azemi kërkuam që të na mundësoj risistemimin tonë në radhët e UÇK-së. Dëshira jonë ishte të futeshim në Kosovë, mirëpo Azemi kërkoi që ne të zbatojmë detyrat, të cilat aktualisht janë me prioritet, ndaj na urdhëroi që të shkonim në zonën e veriut të Shqipërisë, më saktë të paraqiteshim tek komandanti i zonës, Xheladin Gashi - Plaku.

Sheradin Berisha: *Kur udhëtuat në zonën e veriut, atje ku bëheshin përgatitjet e fundit për t'u futur në Kosovë?*

Idriz Mehmeti: Menjëherë të nesërmen kemi udhëtuar për në Krumë të Hasit, dhe atje kemi arritur në mbrëmje. Pastaj në mëngjesin e të nesërmes e kemi takuar Komandant Plakun dhe sipas marrëveshjes me ministrin Azem Syla, jemi sistemuar secili nga ne, në detyra të caktuara.

Fillimisht komandant Xheladin Gashi - Plaku, ka organizuar një takim për ne me komandantin e Divizionit të Kukësi të Ushtrisë Shqiptare, Gjeneralin Kudusi Lame, në mënyrë që gjenerali të na jepte udhëzimet, lidhur me angazhimet tona dhe mënyrën e kombinimeve të veprimeve ushtarake në mes të UÇK-së dhe Ushtrisë Shqiptare.

Sheradin Berisha: *Ku u mbajt takimi?*

Idriz Mehmeti: Takimi është mbajtur në zyrën e Gjeneralit Kudusi Lame. Me lejoni t'ju rrëfej një ngjarje me rëndësi që ndodhi derisa ishim në takim me gjeneralin Lame. Derisa po qëndronim në zyrën e Gjeneralit, erdhi njëri ndër luftëtarët më të përkushtuar të Zonës së Dukagjinit, Nasim Haradinaj. Kishte ardhur për t'u furnizuar me teknike luftarake. Kërkesa për furnizim ishte bërë gati dhe ishte në pritje të urdhërit për nisje në vijë të frontit, në Koshare. Këtë na e konfirmoi pak më parë Gjenerali, para se të vinte në zyrë Nasimi. Mirëpo, fillimisht Babushi bëri një shaka interesante me të: "Kush jeni ju hej, që doni ta fusni Shqipërinë në luftë,... etj, dhe vini këtu në zyrë të komandantit të Divizionit; bile kërkoni edhe mjete luftarake"! Për momentin Nasimi u step, por Babushi nga shakaja kaloi në zbatim të detyrës. E përqafoi Nasimin dhe urdhëroi njërin nga oficerët e tij që rrinte te dera në këmbë: "merre djalin e dërgoje tek Magazina"! Si urdhëron Gjeneral - përshëndeti oficeri, dhe iu drejtua Nasimit: ejani me mua. Nasimi doli, por pas pak u kthye, e përqafoi shumë Babushin, ra më gjunjë e ia puthi këmbët...O Babushi im! - i tha Gjeneralit, përsëri e përqafoi dhe iku në detyrë. Ai kishte marrë gjithë kërkesën furnizuese, ndaj e puthte Babushin. Në këtë moment, m'u kujtuan bisedat dhe optimizmi i Komandant Adem Jasharit për ndihmën që do të na jap Shqipëria. Vetë me vete mendova: ja Shqipëria e Adem Jasharit!

Sheradin Berisha: *Me çfarë detyre u ngarkuat?*

Idriz Mehmeti: Me 6 prill kemi shkuar në një repart ushtarak të UÇK-së, në Kukës dhe i kemi pranuar detyrat e reja. Mua më emëruan zv. Komandant i Xheladin Gashit (komandant Plakut) për tri qendra ushtarake të zonës Kufitare: në Helshan, Vlahnë dhe Cahanë.

Qendra e Helshanit ishte planifikuar si pikë stërvitore, me Komandant Kolonel Maliq Doçin, ish oficer i Ushtrisë Shqiptare.

Pika e Vlahnës, ishte pikë furnizuese me Komandant, Sami Ukshinin - Sokolin, ndërsa pika e Cahanit ishte pikë Pushimi me komandant Haki Hajdarin (Haki Drenica), nga ku futeshin grupe të armatosura kohë pas kohe në Kosovë, por edhe çlodheshin luftëtarët kur ktheheshin nga Kosova që vinin për furnizim.

Të tria këto pika ishin të vendosura në reparte ushtarake, që shteti Shqiptar i kishte vënë në dipozicion të UÇK-së.

Gjatë gjithë kohës sa kam qenë në këtë pozitë për tri pikat e lartë cekura, jam përpjekur maksimalisht dhe me korrektësi në ngritjen dhe stërvitjen e organikës ushtarake. Pika e Helshanit, meqë ishte pikë stërvitore, aty kishim numrin më të madh të ushtarëve, ishin rreth 1.200 ushtarë vullnetarë, edhe aty e kam pasur selinë. Çdo ditë, së bashku me Kolonel Maliq Doçin, kemi inspektuar stërvitjet ditore të parapara me plane ushtarake.

Sheradin Berisha: *Në këtë kohë, pas mobilizimit të përgjithshëm (prill - maj 1999), a kishte eprorë të majftueshëm në qendrën stërvitore të Helshanit etj., për t'i kryer detyrimet ushtarake karshi vullnetarëve të shumtë?*

Idriz Mehmeti: Gjer në ditët e para të majit 1999, në këto reparte në radhët e UÇK-së kishin ardhur disa ish oficerë të Ushtrisë Shqiptare, si: Kolonel Spiro Butka, Nënkolonel Arqile Mandro, Agim Sallaku, Ermir Bega, Driton Durmishi, Nevruz Mema, Rifat Dervishi, Hasan Keko etj. Ndërkaq Mobilizimit të Përgjithshëm të shpallur nga SHP i UÇK-së, ishin përgjigjur edhe disa oficerë Shqiptar nga Kosova (ish oficerë të APJ-së): Shaban Musliu, Bilall Syla, Ibër Elezi, Skënder Misiri, Bashkim Lladrovci, Ilir Daka, Nexhip Osmani, Shefki Avdullahu e të tjerë!

Të gjithë oficerët, po edhe vullnetarët ushtarë, me seriozitet dhe përkushtim i kryenin detyrat e veta. Me këtë rast do ta veçoja përkushtimin e oficerit, Bilall Syla. Bilalli ishte njeri modest, serioz dhe shumë i përkushtuar në aspektin profesional. Në Helshan mund të them se, kemi pasur një Shqipëri të vogël Etnike; ushtarë, vullnetarë nga të gjitha viset Shqiptare.

Sheradin Berisha: *A kishte edhe femra shqiptare në radhët e vullnetarëve?*

Idriz Mehmeti: Po, kishte edhe femra: nga Kosova dhe Shqipëria... nga Durrësi, nga Presheva, nga Kumanova. Mbaj mend se nga Kumanova ishte Shkodra Aqifi, një vajzë e re dhe një personifikim i denjë i shembëlltyrës legjendare të Ismet Jasharit - Komandant Kumanova - një emër hero i Atdheut tonë. Një ditë tek përgatiteshim për ta nisur një kontigjentë ushtarësh për në frontin e Koshares, ishin të pranishëm edhe tre oficer të NATO-s, që kishin ardhur për inspektim. Në ato çaste krenarie dhe skajshmërisht prekëse, Shkodra Aqifi, si shqiponjë e lashtë Karadaku, rrëmbeu megafonin e komandës ushtarake në dorë dhe filloi të recitojë poezi që të çonte peshë. Edhe më emocionues ishte këmbëngulja e saj për të shkuar në front, përkundër vendimit të komandës që të mos e dërgoj atë në frontin e Koshares, për shkak të moshës së re. Madje ishte interesante dhe mënyra se si i bindi eprorët e vet që t`i bashkohet ajo aradhës ushtarake për frontin e Koshares. Gjithmonë më flen në sytë e mi ngazëllimi i asaj shqiponje kur e mori pushkën në dorë. M'u duk sikur në atë moment ëndrra e saj po realizohej. Në këtë atmosferë të krijuar, ushtarët që do t'i bashkoheshin frontit në Koshare këndonin, ndërsa të tjerët që kishin dalë t`i përcillnin qanin. Kjo dukuri iu bëri përshtypje inspektuesve të NATO-s, ndaj pyetën pse këta qajnë e tjerët këndojnë. Përgjigjen me gjuhën e ushtarakut e dha Kolonel Maliq Doçi. U befasuan nga ky fenomen i paparë!

Sheradin Berisha: *Bac, më 9 prill 1999 ishte hapur fronti i luftës në Koshare. Helshani ishte qendra kryesore ku përgatiteshin vullnetarët e*

UÇK-së, fizikisht dhe ushtarakisht për luftë. Ju më lartë përmendet se, nga qendra stërvitore e Helshanit keni dërguar ushtarë në Koshare. A mund të na pasqyroni këtë gjë?

Idriz Mehmeti: Po, nga pika stërvitore e Helshanit, në freskim të vijës së frontit në Koshare, kemi arritur t`i stërvisim dhe t'i pajisim me mjete luftarake, fillimisht 85 ushtarë dhe me datë 15 prill kemi nisur për Koshare, nën komandën e eprorit Nasim Haradinaj. Në këtë grup ishte edhe një togë speciale e përgatitur nga dy ushtarakë të huaj, (një englez dhe një suedez), të cilët ishin sistemuar në radhët e UÇK-së. Ndërsa me 28 prill, kemi nisur një Batalion prej 204 ushtarësh, të pajisur me të gjitha mjetet e luftës! Në kuadër të kësaj trupe ka qenë e përgatitur një Togë Speciale, të cilën e patën stërvitur këta dy oficerë të huaj. Në këtë Togë prej 30 vetash ishte edhe miku im, Xhemë Nura, me të cilin edhe kishin ardhur dy oficerët e huaj për ta ndihmuar UÇK-në! Sipas informatave që kam marrë më vonë, ajo togë ka shkëlqyer në vijën e frontit në Koshare.

Sheradin Berisha: *Ato ditë të fillim majit 1998, a ishte rritur numri i vullnetarëve në qendrën stërvitore të Helshanit?*

Idriz Mehmeti: Po, numri i vullnetarëve në fund të prillit dhe fillim të majit u rritë shumë! Në javën e dytë të majit, në Helshan, bashkë me ish oficerët shqiptarë, si dhe disa ish oficerë të armatës jugosllave (shqiptarë të Kosovës), kemi formuar brigadën, e cila nën komandën e oficerit Bilall Syla, fillimisht transferohet në qendrën stërvitore "Feken", e pastaj bëhet pjesë e operacionit "Shigjeta". Unë nuk pata fatin të jem pjesë e Shigjetës, ngase u ngarkova me një detyrë tjetër.

Sheradin Berisha: *Bac, nga të dhënat që kam unë, eprori Bilall Syla, bashkë me eprorët Bashkim Lladrovci dhe Shaban Musliu, për t'iu bashkuar radhëve të UÇK-së në Shqipëri kanë ardhur në mars të vitit 1999. Më 20 mars fillimisht janë vendosur në Vlahnë, ndërsa në fillim të prillit kanë ardhur në qendrën stërvitore të Helshanit. Dhe më 13 maj 1999, pasi formohet Brigada (siç thoni ju) komandant Bilall Syla transferohet në Qendrën Stërvitore të "Fekenit", afër Tiranës.*

Tani të ndalemi me një moment tjetër të rëndësishëm historik.

Në gjysmën e dytë të prillit 1999, (pikërisht në këtë kohë për të cilën po flasim), SHP i UÇK-së, e emron Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Bislim Zyrapi, për Komandant të operacionit "Shigjeta", i cili ishte planifikuar të zhvillohej në Pashtrik gjatë muajit maj 1999. B.Zyrapi pasi ngarkohet me këtë detyrë, bashkë me një grup eprorësh, në javën e fundit të prillit nga Kosova nëpër Maqedoni udhëton për në Shqipëri. Ndërkohë në të njejtën linjë për këtë mision udhëtojnë për në Shqipëri Fatmir Limaj, me Musë Jasharin e disa të tjerë. Në fillim të majit Komandanti B.Zyrapi, në kuadër të punës për formimin e Shtabit të Operacionit "Shigjeta", i viziton disa qendra stërvitore. Kolonel Zyrapi a ishte për vizitë edhe në Helshan?

Idriz Mehmeti: Bislim Zyrapi ka qenë në Helshan, derisa isha edhe unë atje. Kur ka ardhur Bislimi në Helshan, në bazë të direktivave të Gjeneral Kudusi Lamës, dhe me angazhimin e të gjithë oficerëvet që kishim aty, nën drejtimin e Kolonel Maliq Doçit, organika ushtarake ka qenë e përfunduar, nga skuadra, togjet, kompanitë, batalionet, deri në Brigadë me Komandant Bilall Sylën! Pastaj pas tre katër ditësh unë kam shkuar në detyrë tjetër dhe e di që Bilalli me Brigadën e tij (siç thash më lartë) ka shkuar në Stëvitoren e Fekenit.

Sheradin Berisha: *E qartë! Në javën e parë të muajit maj 1999, në Kukës u ngrit Shtabi i Operacionit "Shigjeta" me në krye Bislim Zyrapin. A ishit edhe ju pjesë e kësaj strukture?*

Idriz Mehmeti: Nuk kam marrë pjesë në krijimin e shtabit të këtij operacioni! Unë kam qenë i ngarkuar me detyrën e zv.komandantit, për tri pikatë ushtarake: Helshan, Vlahnë dhe Cahanë dhe në bazë të autorizimit që kisha, kam zbatuar vetëm urdhërat e komandantit të zonës së veriut, Xheladin Gashit - Plakut!

Sheradin Berisha: *Po, ky fakt tashmë është i ditur! Bac, në një dokument arkivor të operacionit "Shigjeta", me titull: "Struktura*

organizative e operacionit "Shigjeta", në kuadër të Komandës së Shtabit figuron edhe emri juaj si "shefi i personelit dhe resurseve"?!

Idriz Mehmeti: Nuk e kam parë atë dokument të plotë, dhe nuk më është i njohur sa duhet, por mund t'ju them se: në bazë të urdhëresës së Komandant Plakut, në repartin stërvitor të Helshanit, kishim afërsisht 1200 ushtarë, dhe detyra jonë ka qenë: krijimi i strukturës organike, emërimi i kuadrove, hierarkia komanduese, trajnimi, dhe paisja me mjete luftarake, i një Brigade ushtarake për mësymje! Dhe këtë e kemi arritur, e kemi bërë plotësisht në baza profesionale, dhe me përkushtim e diciplinë!

Sheradin Berisha: *Çfarë pozite kishte Komandant Plaku pas krijimit të Shtabit të Operacionit 'Shigjeta', në krye me Bislim Zyrapin, me seli në Kukës?*

Idriz Mehmeti: Plaku ishte komandant i gjithë zonës së veriut, dhe gjatë gjithë kohës ishte në lëvizje. Pra gjithnjë ishte në teren, në Koshare, Padesh, Babinë, Helshanë, Vlahnë, Cahan, Krumë, Kukës, Fushë-Dukagjin, Kalimash, Fekën, e gjetiu, por selin e kishte në Krumë!

Sheradin Berisha: *Bac, në prill-maj 1999 përveç këtyre tri qendrave ku ju ishit zv.komandant i komandant Plakut, në Shqipëri ekzistonin edhe disa qendra tjera stërvitore, si i përmendët edhe ju më lartë. A e dini numrin e përgjithshëm të vullnetarëve që u stërvitën aty, për t'u përballur me forcat pushtuese serbe gjatë operacionit "Shigjeta" në Pashtrik dhe në Koshare?*

Idriz Mehmeti: Siç i përmenda më lartë ka pas disa pika fushimi, siç i quanim ne, por unë di të flas vetëm për repartet ku kam shërbye vet! Pra para mësymjes në Pashtrik: në Helshan kishim rreth 1.200 ushtarë, vullnetarë, ndërsa në Vlahnë e Cahan për shkak të kapaciteteve më të vogla të hapësirave kishim më pak, numri sillej nga 70-80 gjer 100 veta, por kishim lëvizje të vullnetarëve, sepse ca vinin e ca tjerë shkonin, i bashkoheshin frontit në Koshare!

Sheradin Berisha: *Në fillim të bisedës kur shkuat në zonën e veriut e përmendëm takimin që keni pasur me gjeneral Kudusi Lamen. A mund të na thoni, cili ishte roli i Gjeneral Kudusi Lamës dhe i Divizionit të Kukësit, në përgatitjet psiko-fizike të vullnetarëve dhe atë të logjistikës për Operacionin "Shigjeta"?*

Idriz Mehmeti: Roli i Gjeneral Kudusi Lamës ka qenë krucial, do të thosha unë! Pa angazhimin e tij personal, serioz e zyrtar, operacioni Shigjeta as që do të mund të përmendej! Po a e dini Ju, që Gjenerali ishte Komandant i gjithë Zonës Operative të Veriut të Shqipërisë, i ushtrisë së shtetit Shqiptar, dhe se e gjithë zona, ashtu në heshtje për arsye të ditura, ishte në shërbim të luftës së Kosovës, pa ndonjë vendim në letër, por me veprime praktike në teren!

Sheradin Berisha: *Kush i merrte vendimet apo urdhërat gjatë kësaj kohe?*

Idriz Mehmeti: Të gjitha vendimet, (unë jam i prirur të them: urdhëresat), direkt merreshin nga Ministri i Mbrojtjes, Azem Syla, Gjeneral Kudusi Lame dhe Xheladin Gashi - Komandant Plaku, ndërsa ne të tjerët i kemi zbatuar ato urdhëra! Tek çdo ushtri në botë, edhe nëse nuk është në gjendje lufte, në bazë të hierarkisë ushtarake ka vetëm: Urdhëro! Si urdhëron!, e lene më në rastin tonë kur lufta ishte në vlugun më të madh!

Sheradin Berisha: *Çfarë detyrash keni kryer pas formimit të organikës së Brigadës në Helshan?*

Idriz Mehmeti: Pas përfundimit të organikës ushtarake të Brigadës dhe emërimit të Bilall Sylës për komandant, kam zbritur në Kukës, në zyrën për informim, ku ishte përgjegjës Gani Syla. Pas 5-6 ditësh kam shkuar në Tiranë! Kohë pas kohe kam qëndruar tek zyra e Qeverisë së Përkohshme, sa për t'u informuar se si po zhvillohen ngarjet! Pas marrëveshjes së Kumanovës, më 9 qershor 1999, kam shkuar në Zvicër!

Sheradin Berisha: *Si e përjetuat përfundimin e luftës?*

Idriz Mehmeti: Ishte fundi i qershorit. Nga Zvicra bashkë me vëllain Halilin, me një furgon me gjërat më elementare udhëtuam për në Kosovë, për t'ia dërguar familjarëve tanë të mbijetuar. Udhëtuam nga Berni i Zvicrës në Bari të Italisë, dhe e morëm tragetin e parë që mundëm. "Rasti thonë është mbreti i botës"! Në Traget takuam bacin Rifat Jashari, Muratin, Bekimin dhe Lulin! E çuditshme! Pas gjithë asaj dhembjeje, çfarë qëndrimi! Thua se shkonin në dasëm. E kam bindjen e patundur, se në të gjithë botën nuk ka familje më të fortë. Vetëm ata dinë dhe mund të jenë kështu si janë. Të nesërmen udhëtuam nga Tirana në Kukës; e lamë Kukësin, arritëm në kufirin që ndante Shqipërinë e Kosovën. Në kufi, mu në kufi, Komandant Sami Lushtaku kishte dalë ta priste bacin Rifat me Muratin e me nipat: Bekimin e Lulin. Jemi përqafuar me Samiun, i kemi uruar njëri tjetrit fitoren e lirisë, i kemi shprehur njëri tjetrit ngushëllime për të rënët, familjarët, po edhe për shokët tanë të përbashkët. Kaluam nëpër Prizren, Rahovec, Malishevë, Drenas... Gjithandej varre, djegie, shkatërrime, dhe në fund arritëm në trojet tona po ashtu të djegura, por të lira. Ishte e dhimbshme nga krejt ai holokaust që kishte përjetuar Kosova dhe populli saj. Megjithatë, liria kishte ëmbëlsinë e vet. Jeta do vazhdojë tutje, do bëhen varrime e rivarrime, vizita e ngushëllime.

Sheradin Berisha: *Pas përfundimit të luftës, UÇK-ja u demobilizua dhe u shndërrua në TMK! Ju u radhitët në TMK, apo u demobilizuat?*

Idriz Mehmeti: Pas vendimit për shndërrimin e UÇK-së në TMK, në shtator 1999 ia kam dorëzuar pushkën time komandant Mehmet Gjelit nga Likoshani i Drenicës. Ai ishte i ngarkuar për grumbullimin dhe dorëzimin e armatimit në atë pjesë ku kishte operuar edhe kompania ushtarake e fshatit tim, e cila ka qenë pjesë e Brigadës 114 "Fehmi Lladrovci". Pas këtij akti, përfundimisht jam çmobilizuar dhe jam kthyer në Zvicër, ku vazhdoj të jetoj edhe sot me familjen time!

Sheradin Berisha: Ju faleminderoj për bashkëbisedimin.

~~~~~~
~~~~~~

F O T O A L B U M I



99 4.26



USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS

SH.L.O. i Drenicës

Njësia Operative

LEJE UDHËTIMI

Nr. - Më 11.02 1998

I lejohet ushtarit Idriz Mehmeti udhëtimi

në relacionin Drenicë - Tiranë

më datën 11.02 1998 prej orës 18 deri më datën - 1998 në orën

Për nevoja Ushtarake

Me vete posedon armatimin mik poredon.

Komandanti

Me 11.02.1998

Sylejman Selimi

Alpeve

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMISIONI QEVERITAR PËR NJOHJEN DHE VERIFIKIMIN E STATUSIT TË DËSHMORIT TË KOMBIT, INVALIDIT, VETERANIT, PJESËTARIT APO TË INTERNUARIT TË UÇK-së

UÇK

Certifikatë

Idriz I Mehmeti

Veteran Luftëtar
i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Kryetar i Komisionit

Gjeneral lejtnant. AGIM ÇEKU
shef i SH.P. të UÇK-së

Nr. prot: 24/3995
Data: 06.08.2015

~~~
~~~